



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2026/0069**

OSHP: 2026/0073

OSHP: 2026/0074

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Isa Hasani-kryetar, Vedat Poterqoi dhe Kimete Gashi-anëtare, duke vendosur sipas ankesës së OE "Acerler Insaat Taahot MadenCilik Muhedislik Nakliyat Ve Sarrafiye Tiic.LTD.Sti, ,OE"Ada Consulting Group" SH.P.K. dhe OE "Nika PrO- Ing SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit “RITENDER “Ndërtimi i Qendrës se Mjekësisë Emergjente ne QKUK – vazhdim projekti” me numër të prokurimit; 206-25-8662-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – MINISTERIA E SHËNDETËSISË, më 03.04.2026, mori këtë:

## **Vendim**

1. Aprovohen si pjesërisht të bazuara ankesat: OE"Acerler Insaat Taahot MadenCilik Muhedislik Nakliyat Ve Sarrafiye Tiic.LTD.Sti", me nr. 2026/0069, e datës 04.02.2026, OE"Ada Consulting Group" SH.P.K., me nr. 2026/0073, e datës 05.02.2026, dhe OE"Nika PrO- Ing" SH.P.K., me nr. 2026/0074, e datës 05.02.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit “RITENDER “Ndërtimi i Qendrës se Mjekësisë Emergjente ne QKUK – vazhdim projekti”, me numër të prokurimit; 206-25-8662-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – MINISTERIA E SHËNDETËSISË.
2. Mbetet në fuqi B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - Ministria e Shëndetësisë, për aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Qendrës se Mjekësisë Emergjente ne QKUK – vazhdim projekti”, me numër të prokurimit; 206-25-8662-5-1-1.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

4. Lejohet kthimi i mjeteve të depozituara në emër të tarifës ankimore sipas paragrafi 4 të nenit 31 të Rregullores së Punës së OSHP per ankesat Nr; 2026/0069,Nr; 2026/0073 dhe Nr; 2026/0074 kurse ankesit kanë të drejtë që sipas paragrafi 6, të dispozitës së cituar, të kërkojë kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## Arsyetim

*- Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Me 24.09.2025, MINISTRIA E SHËNDETËSISË, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “RITENDER “Ndërtimi i Qendrës së Mjekësisë Emergjente në QKUK – vazhdim projekti” me numër të prokurimit 206-25-8662-5-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 20,901,160.00 €.

Me 16.01.2026 AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 ku ka shpërblyer me kontratë GOE Grupi i Operatorëve Ekonomik CONSTRUMAX SH.P.K.; TOP PROJEKT SH.P.K.; HARST Group SH.P.K.; EKOTERMIKA SH.P.K.

Me 21.01.2026, OE Acerler Insaat Taahot MadenCilik Muhedislik Nakliyat Ve Sarrafiye Tiic.LTD.Sti, ADA CONSULTING GROUP SH.P.K., dhe NIKA PrO- Ing SH.P.K., kanë parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues.

Me 26.01.2026 dhe 29.01.2026, Autoriteti Kontraktues ka publikuar vendimin përmes të cilit refuzohen si të pa bazuara ankesat e të tre Operatorëve Ekonomik dhe vërtetohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Me 04.02.2026, OE Acerler Insaat Taahot MadenCilik Muhedislik Nakliyat Ve Sarrafiye Tiic.LTD.Sti, ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 0069/2026 ndërsa me datë 05.02.2026 OE ADA CONSULTING GROUP SH.P.K., ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 0073/2026 si dhe OE NIKA PrO- Ing SH.P.K., ka parashtruar ankesën me nr. 0074/2026.

*-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-*

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të tri ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 0069/2026, ankesa nr. 0073/2026 dhe ankesa nr. 0074/2026 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

*-Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Acerler Insaat Taahot MadenCilik Muhedislik Nakliyat Ve Sarrafiye Tiic.LTD.Sti, janë parashtruar si në vijim:*

Autoriteti Kontraktues: Ministria e Shëndetësisë, me datë 26.01.2026 ka publikuar vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim, me të cilin kërkesa jonë është refuzuar si e pabazuar, duke i hedhur poshtë të gjitha pretendimet tona.

Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me parimin e barazisë në trajtim dhe mosdiskriminimit, duke zbatuar standarde të ndryshme për operatorë ekonomikë në situata të njëjta faktike.

Konkretisht:

Kërkesa për sqarim e një operatori ekonomik është refuzuar me arsyetimin se është paraqitur jashtë afatit ligjor,

ndërsa një kërkesë tjetër për sqarim, ndonëse gjithashtu jashtë afatit, është pranuar dhe i është lejuar të bëjë ndryshime thelbësore në ofertë.

Në këtë rast është lejuar:

lehtësimi i një kriteri për inxhinierët, edhe pse ka ekzistuar vetëm një kërkesë për sqarim, gjë që cenon tërësisht procedurën,

dhe kjo është arsyetuar nga AK me shprehjen “për hir të projektit”, pas paraqitjes së kërkesës.

Ky veprim përbën ndërhyrje të palejuar në ofertë pas afatit të dorëzimit, në kundërshtim me legjislacionin për prokurim publik dhe praktikën standarde të vlerësimit të ofertave.

Nëse një operator penalizohet për paraqitje jashtë afatit, atëherë i njëjti standard duhet të zbatohet për të gjithë operatorët pa përjashtim. Lejimi që një operator të modifikojë ofertën pas afatit, ndërkohë që të tjerëve u refuzohet çdo e drejtë procedurale për të njëjtin shkak, krijon dyshime serioze për favorizim të qëllimshëm të operatorit fitues.

Ky trajtim i pabarabartë:

cenon parimin e konkurrencës së ndershme,

bie ndesh me transparencën,

dhe e bën vendimin e AK-së të pabazuar dhe të anshëm.

Prandaj, që në fazën e përgatitjes së dosjes së tenderit janë shfaqur indikacione për drejtimin e kontratës.

Sa i përket trajtimit të pyetjeve për sqarim gjatë procesit të vlerësimit të ofertave, konstatojmë se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në mënyrë selektive dhe të padrejtë, duke favorizuar një nga operatorët ekonomikë, ndërkohë që ne nuk kemi kërkuar asnjë sqarim dhe nuk kemi pasur trajtim të barabartë.

Konkretisht:

Një operator ekonomik ka paraqitur pyetje për sqarim lidhur me dokumentacionin e stafit profesional dhe AK ka pranuar korrigjime jashtë afatit të përcaktuar në FDT,

ky veprim i ka krijuar avantazh të padrejtë operatorit të rekomanduar, duke i mundësuar përmirësimin e dokumentacionit dhe plotësimin e kriterëve,

ndërkohë që operatorë të tjerë, përfshirë ofertën tonë, nuk janë trajtuar në të njëjtën mënyrë.

Ky veprim bie në kundërshtim me nenin 7 dhe nenin 59 të LPP-së, pasi nuk është garantuar vlerësim i drejtë dhe i barabartë i të gjitha ofertave.

Për rrjedhojë, favorizimi i operatorit të rekomanduar përmes lejimit të sqarimeve selektive përbën shkelje të rëndë procedurale dhe të parimit të konkurrencës së hapur, duke e bërë vendimin për rekomandim të kontratës të paligjshëm dhe juridikisht të paqëndrueshëm.

Kërkojmë nga OSHP:

Të konstatojë shkeljen e trajtimit të barabartë;

Të urdhërojë rivlerësimin e ofertave në përputhje të plotë me FDT dhe LPP.

Pretendimi 1

Veprimi i Autoritetit Kontraktues bie ndesh me nenin 1 të LPP-së, pasi eliminimi për një pasaktësi llogaritëse në një pozicion derivues, që nuk ndikon në çmimin njësi dhe renditjen e tenderuesve, cenon proporcionalitetin dhe konkurrencën e drejtë.

Në pozicionet e kontestuara të paramasës, vetë Dosja e Tenderit përcakton se vlera e tyre duhet të llogaritet si përqindje e pozicioneve paraprake dhe jo si çmim i pavarur i ofertuar nga operatori ekonomik.

Këto pozicione kanë natyrë derivuese dhe llogaritëse, pasi vlera e tyre rrjedh drejtpërdrejt nga aplikimi i formulës së përcaktuar nga AK në dokumentacionin e tenderit.

Klasifikimi i kësaj pasaktësie si ndryshim i çmimit njësi përbën shkelje të nenit 7 të LPP-së, pasi krijon trajtim të pabarabartë dhe kriter joproporcional.

Natyra e gabimit – gabim aritmetik/llogaritës

Pasaktësitë lidhen me bazën e llogaritjes së formulës matematike dhe jo me ndryshim të qëllimshëm të çmimit për njësi. Çmimet bazë janë të sakta dhe të pakontestuara, ndërsa vlerat derivuese janë të përcaktueshme objektivisht.

Ky gabim përbën gabim aritmetik në kuptim të nenit 59, paragrafi 3 të LPP-së, i cili lejon korrigjimin e tij.

Autoriteti Kontraktues ka dështuar ta zbatojë këtë dispozitë, duke mos e trajtuar pasaktësinë si të korigjueshme.

Korigjimi:

nuk ndryshon çmimin njësi,

nuk ndryshon përmbajtjen ekonomike të ofertës,

dhe nuk ndikon në renditje.

Prandaj, trajtimi i këtij gabimi si ndryshim material është disproporcional dhe në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së.

Pretendimi 2

Eliminimi i operatorit ekonomik është bërë në kundërshtim me LPP-në.

Shkelja e nenit 72 – moskërkimi i sqarimeve

AK ka pasur obligim të kërkojë sqarime, pasi dokumentacioni ishte i paraqitur dhe kërkonte vetëm interpretim.

Refuzimi për të kërkuar sqarime bie ndesh me nenin 72 të LPP-së.

Shkelja e proporcionalitetit dhe konkurrencës

Eliminimi për mungesë formale, përkundër ekzistimit të dëshmive teknike, është disproporcional dhe kufizon konkurrencën.

Ne kemi dëshmuar përvojë në objekt spitalor me të gjitha pozicionet e kërkuara, ndërsa operatori i rekomanduar nuk ka dëshmuar një objekt të vetëm të tillë në tërësi, por vetëm pozicione të fragmentuara.

Kjo bie ndesh me kërkesat e FDT-së dhe nenin 59 të LPP-së.

Po ashtu, AK ka dështuar të zbatojë nenin 72 duke mos kërkuar sqarime.

Rekomandimi i një operatori që nuk i plotëson kriteret cenon edhe nenin 6 të LPP-së.

Pretendimi 3

Pretendimi i AK-së se tekniku i arkitekturës z. Endrit Berisha nuk e përmbush përvojën 5-vjeçare është i pabazuar.

Nga projektet e paraqitura dhe periudhat kohore rezulton qartë se përvoja është e plotësuar.

Megjithatë, AK nuk ka dhënë asnjë arsyetim konkret për këtë pretendim, duke bërë vetëm refuzim formal.

Kjo përbën shkelje të nenit 108/A të LPP-së dhe të praktikës së OSHP-së.

Mos-shqyrtimi i pretendimeve konkrete, mungesa e arsytimit dhe aplikimi i standardeve të dyfishta përbëjnë shkelje të rëndë procedurale dhe cenojnë trajtimin e barabartë.

#### Përfundim

Për të gjitha arsyet e lartcekura, i propozojmë OSHP-së që:

të konstatojë shkeljet procedurale dhe materiale,

të anulojë vendimin e Autoritetit Kontraktues,

dhe ta kthejë lëndën në rivlerësim me detyrim për shqyrtim objektiv, të arsyetuar dhe të barabartë të të gjitha ofertave.

#### Pretendimi 4 – Teknikja e IT-së

Mospërputhja e evidentuar në CV-në e znj. Florijona Osmanaj është pasojë e një gabimi teknik/administrativ në paraqitjen e të dhënave dhe në asnjë mënyrë nuk përbën mungesë faktike të përvojës profesionale. Përvoja profesionale ekziston, është reale dhe objektivist e verifikueshme përmes dokumentacionit përkatës.

Në këto rrethana, Autoriteti Kontraktues ka pasur obligim ligjor të kërkojë sqarime, në përputhje me nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili i lejon dhe e obligon AK-në të kërkojë sqarime lidhur me dokumentet e dorëzuara, për aq kohë sa kjo nuk sjell ndryshim të ofertës apo avantazh të padrejtë.

Për më tepër, veprimi i AK-së bie ndesh edhe me nenin 69 të LPP-së, i cili, në përputhje me Udhëzuesin Nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, pika 10 “Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit”, përcakton qartë se, kur CV-ja e dorëzuar nuk përmban të gjitha informatat e kërkuara, Autoriteti Kontraktues nuk duhet të eliminojë ofertën automatikisht, por ka të drejtë dhe mundësi të kërkojë informata sqaruese nga operatori ekonomik.

Në rastin konkret, tekniku ka paraqitur CV dhe përvojë pune në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit, ndërsa Autoriteti Kontraktues, duke mos e shfrytëzuar instrumentin ligjor të sqarimit, ka aplikuar një qasje formale dhe ndëshkuese, në kundërshtim me frymën dhe qëllimin e LPP-së.

Eliminimi i ofertës për një gabim formal dhe të korrigjueshëm, pa kërkuar sqarime, përbën shkelje të rëndë të parimit të proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë, të përcaktuar në nenin 7 të LPP-së, si dhe përbën zbatim të gabuar të dispozitave ligjore dhe udhëzimeve administrative në fuqi.

Si rrjedhojë, veprimi i Autoritetit Kontraktues është i paligjshëm, joproporcional dhe diskriminues, dhe ka rezultuar në eliminim të padrejtë të operatorit ekonomik, pa u respektuar procedurat ligjore për sqarim dhe verifikim të dokumentacionit.

#### Pretendimi 5 – Certifikatat për z. Sabit Bytyqi

Pretendimi për mungesë të certifikatave bazohet në faktin se fajllat përkatës janë vlerësuar si “blanko”. Kjo përbën mangësi teknike në ngarkimin e dokumenteve dhe jo mungesë faktike të stafit apo kualifikimeve. Sipas nenit 72 të LPP-së, kjo situatë duhet të adresohet përmes kërkesës

për sqarim dhe jo përmes eliminimit.

Në vijim paraqesim edhe faktin se vetë Autoriteti Kontraktues, në përgjigjen e tij, de facto pajtohet se nuk është vepruar në harmoni me ligjin lidhur me refuzimin e ofertës sonë për pozitën Inxhinier i Hidroteknikës, duke vepruar me paragjykim, siç rezulton nga vetë komentimi i zyrës së prokurimit të AK-së për këtë pikë.

Pra, dokumenti është bashkëngjitur, mirëpo për shkak të një gabimi teknik ka rezultuar i bardhë (“blanko”), ndërkohë që është e provuar se certifikatat janë lëshuar para afatit të dorëzimit të ofertës.

Në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues e ka pranuar këtë dokument dhe ka konstatuar se pretendimi është pjesërisht i bazuar.

Megjithatë, përkundër këtij konstatimi, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim në tërësi, pa ndërmarrë asnjë masë korrigjuese.

Ky veprim përbën shkelje të nenit 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik, pasi pranimi, qoftë edhe i pjesshëm, i një pretendimi e obligon AK-në të korrigjojë vendimin e kontestuar.

Një vendim i tillë është i paarsyetuar, kontradiktor dhe arbitrar, duke cenuar sigurinë juridike dhe duke pamundësuar ushtrimin efektiv të së drejtës së ankesës para OSHP-së.

#### Pretendimi 6 – Certifikata e saldimit

Vetë Autoriteti Kontraktues pranon se pretendimi nr. 6 është pjesërisht i bazuar, duke marrë parasysh certifikatën e saldimit të lëshuar më 23.10.2020, e cila dëshmon përvojë të mjaftueshme pas certifikimit. Kjo vërteton se kriteri është përmbushur dhe se eliminimi për këtë arsye ka qenë i pajustificuar.

Në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues e ka pranuar këtë dokument dhe ka konstatuar se pretendimi është pjesërisht i bazuar.

Megjithatë, në kundërshtim me këtë konstatim, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim në tërësi, pa ndërmarrë asnjë masë korrigjuese.

Ky veprim përbën shkelje të nenit 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik, pasi pranimi, qoftë edhe i pjesshëm, i një pretendimi e obligon AK-në të korrigjojë vendimin e kontestuar.

Një vendim i tillë është i paarsyetuar, kontradiktor dhe arbitrar, duke cenuar sigurinë juridike dhe duke pamundësuar ushtrimin efektiv të së drejtës së ankesës para OSHP-së.

#### Pjesa e dytë e Ankesës

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës së GOE: “Construmax” Sh.P.K., “Top Projekt” Sh.P.K., “Harst Group” Sh.P.K. dhe “Ekotermika” Sh.P.K., të shpallur fitues, rezulton se kjo ofertë paraqet mospërputhje të shumëfishta dhe substanciale me kërkesat e Dosjes së Tenderit, përfshirë, por pa u kufizuar, në kategoritë në vijim:

#### Pretendimi 1

Autorizime dhe dokumente formale për përfaqësim

Kompania "Construmax" Sh.P.K. ka paraqitur si person të autorizuar znj. Bege Krasniqi. Megjithatë, autorizimi i paraqitur për këtë person rezulton i paplotë dhe i mangët, pasi nuk specifikon qartë të drejtën për përfaqësim të plotë, përfshirë nënshkrimin dhe dorëzimin e dosjes së tenderit.

Edhe pse autorizimi është i noterizuar, ai nuk e përcakton shprehimisht përfaqësimin e Operatorit Ekonomik në këtë aktivitet konkret të prokurimit dhe në këtë procedurë specifike tenderuese, ashtu siç kërkohet në përputhje me dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik dhe kërkesat e Dosjes së Tenderit lidhur me autorizimin dhe përfaqësimin e OE-së.

Për më tepër, në kundërshtim me dispozitat e LPP-së që rregullojnë kriteret e përshtatshmërisë dhe verifikimin e integritetit të Operatorëve Ekonomikë dhe përfaqësuesve të tyre, Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar nga personi i autorizuar dëshminë përkatëse nga gjykata që vërteton se i njëjti nuk është nën hetime. Kjo paraqet shkelje të parimit të trajtimit të barabartë, transparencës dhe zbatimit të njëjtë të kriterëve ligjore ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë.

Në vendimin e Autoritetit Kontraktues është theksuar se znj. Bege Krasniqi ka autorizim me përgjegjësi të plotë për të vepruar në emër të kompanisë, mirëpo nga analiza e autorizimit të paraqitur rezulton se kjo e drejtë nuk është e specifikuar në mënyrë të qartë dhe të plotë.

## Pretendimi 2

Aneksi 6 – Deklarata për themelimin e grupit të Operatorëve Ekonomikë

Aneksi 6 – Deklarata për themelimin e grupit të Operatorëve Ekonomikë nuk përmban të dhënat e plota të personit të autorizuar dhe nuk është e pajisur me vulën e kërkuar, duke e bërë këtë dokument të paplotë dhe të papërrputhshëm me kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Përfshirja e këtij dokumenti në formë të plotë dhe të rregullt është kusht i domosdoshëm për vlefshmërinë e dosjes së tenderit.

Pavarësisht kësaj mangësie thelbësore, Autoriteti Kontraktues nuk e ka marrë këtë parregullsi në konsideratë gjatë fazës së vlerësimit, por përkundrazi ka proceduar me shpërblimin e këtij operatori ekonomik me kontratë, veprim ky që përbën shkelje të rëndë të dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik, si dhe të parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës dhe ligjshmërisë në procedurat e prokurimit publik.

Këto mangësi cenojnë vlefshmërinë formale të ofertës dhe bien ndesh me detyrimin e Autoritetit Kontraktues për të vlerësuar vetëm ofertat që përmbushin kërkesat e Dosjes së Tenderit, në kuptim të nenit 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, si dhe parimin e transparencës sipas nenit 1 të LPP-së.

## Pretendimi 3

Garancia bankare / Letërpërkrahja financiare

Në Dosjen e Tenderit, te pika 8.1 dhe 8.2 (Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare – Kapaciteti ekonomik dhe financiar), është kërkuar që OE ose GOE të dëshmojë se ka mundësi financiare për financimin e kontratës, duke pasur të paktën një (1) milion euro qasje të pakushtëzuar për kredi në dispozicion për realizimin e kontratës (minimum 51% nga lideri në

rast të grupit).

Kjo duhet të dëshmohet me letër konfirmimi (deklaratë) origjinale të nënshkruar dhe vulosur nga institucioni bankar, e cila vërteton disponueshmërinë e një (1) milion eurove në llogarinë bankare të kompanisë për këtë projekt, ose përmes një vërtetimi bankar (shënim premtues) që konfirmon se kompania mund të marrë kredi të pakushtëzuar në këtë shumë. Data e deklaratës nuk duhet të jetë më e hershme se data e publikimit të njoftimit të kontratës dhe duhet t'i referohet aktivitetit në fjalë.

Operatori Ekonomik i shpallur fitues nuk e ka përmbushur këtë kërkesë, pasi ka paraqitur një vlerë prej 980,000.00 EUR, ndërkohë që kërkesa minimale ka qenë 1,000,000.00 EUR.

Mungesa prej 20,000.00 EUR përbën mos-përmbushje të një kriteri eliminues financiar dhe, si e tillë, oferta nuk mund të konsiderohet e përgjegjshme në kuptim të nenit 59 të LPP-së.

Tolerimi i kësaj mospërputhjeje përbën trajtim të pabarabartë ndaj operatorëve të tjerë ekonomikë, në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues, në mënyrë të pajustificueshme, ka marrë parasysh edhe mjete të shpenzuara dhe një konfirmim bilanci nga banka BKT, i cili nuk përmbush kërkesat e Dosjes së Tenderit, duke mos i trajtuar fare pretendimet tona dhe duke i refuzuar ato pa arsyetim të qartë dhe të kuptueshëm.

#### Pretendimi 4

Lista e punëve të kryera dhe përvoja profesionale e kompanisë

Në Dosjen e Tenderit, te pika 9.1 dhe 9.2 (Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale), është kërkuar që OE ose GOE të kenë përfunduar kontrata të punëve të ngjashme në tre (3) vitet e fundit, ndërsa në rast të konzorciumit lideri duhet të ketë realizuar të paktën 51% të tyre.

Gjithashtu, është kërkuar që të dëshmohet përfundimi i së paku një projekti spitalor me vlerë të madhe, ku të jenë kryer punime si: X-ray, gazra medicinale, ventilim, klimatizim, dyer automatike X-ray, etj. Si dëshmi është kërkuar një listë e projekteve me të dhëna të detajuara, origjinale, e vulosur dhe e nënshkruar, e cila duhet të përmbajë: titullin e kontratës, investitorin, të dhënat e personit kontaktues, datën e fillimit dhe përfundimit të projektit, si dhe vlerën e projektit.

Konzorciumi i shpallur fitues ka paraqitur një listë të punëve të kryera, mirëpo kjo listë nuk i përmbush kërkesat e Autoritetit Kontraktues, pasi nuk përmban të dhëna të plota për investitorët, datën e përfundimit të projekteve dhe elemente të tjera thelbësore për identifikimin e projekteve të referencuara.

Për më tepër, nga dokumentacioni i paraqitur nuk rezulton realizimi i një projekti spitalor me vlerë të madhe, siç kërkohet nga Dosja e Tenderit.

Edhe në sqarimet e kërkuara nga AK, konzorciumi ka paraqitur lista të projekteve, por nuk ka dorëzuar pranime teknike apo procesverbale që dëshmojnë përfundimin e projekteve në përputhje me kërkesat. Paraqitja e paramasave të punëve nuk përbën dëshmi valide për përfundimin e projekteve sipas praktikës së prokurimit.

Për më tepër, dokumentacioni lidhur me punimet X-ray i referohet vitit 2019, pra jashtë periudhës trevjeçare të kërkuar nga Njoftimi për Kontratë dhe Dosja e Tenderit. Kjo tregon se OE i shpallur fitues ka tentuar të përmbushë kriterin teknik përmes kombinimit të dokumenteve nga projekte të ndryshme dhe jashtë afatit kohor të kërkuar, në kundërshtim me kërkesën që përvoja të dëshmohet përmes një projekti të vetëm, të integruar dhe brenda periudhës së kërkuar.

Ky veprim përbën shkelje të nenit 59 të LPP-së dhe cenon parimin e trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së drejtë, sipas neneve 1 dhe 7 të LPP-së.

Lista e prezantuar nga GOE i rekomanduar për kontratë nuk përmbush kriteret e kërkuara, pasi nuk përmban të gjitha të dhënat e domosdoshme, siç janë: titulli i kontratës, investitori, të dhënat e personit kontaktues, data e fillimit dhe përfundimit të projektit dhe vlera e projektit.

Autoriteti Kontraktues, në këtë rast, ka dalë edhe jashtë kërkesave të Dosjes së Tenderit, duke pranuar si të vlefshme projekte të përfunduara në vitin 2020 dhe duke i konsideruar si projekte të realizuara brenda tri viteve të fundit.

Për më tepër, edhe në rastin e një kontrate me vlerë 750,000.00 euro, nga pranimi teknik rezulton se janë realizuar punime vetëm në vlerë prej 370,000.00 euro, që nuk e përmbush prapen për kontratë me vlerë të madhe, sipas kategorizimit ligjor.

Gjithashtu, kjo kontratë nuk figuron në listën e projekteve të paraqitura nga GOE, çka e bën edhe më të pabazuar arsyetimin e AK-së.

Sa i përket punimeve X-ray, OE i rekomanduar ka paraqitur dokumentacion të vitit 2019, i cili nuk përmbush kriterin e periudhës trevjeçare dhe nuk lidhet me projektin e pretenduar si projekt i madh spitalor.

Në këtë kontekst, është e qartë se OE i rekomanduar nuk ka dëshmuar përvojën e kërkuar sipas Dosjes së Tenderit, ndërkohë që Autoriteti Kontraktues, në kundërshtim me nenet 7 dhe 59 të LPP-së, ka marrë rolin e justifikimit të ofertës së tij, duke paraqitur dokumente dhe interpretime që nuk burojnë nga vetë oferta e operatorit ekonomik.

#### Prendimi 5

Autoriteti Kontraktues (AK), në Dosjen e Tenderit, ka përcaktuar qartë kriteret e kualifikimit, duke kërkuar që operatorët ekonomikë të posedojnë staf profesional me minimum 10 (dhjetë) vite përvojë pune, si dhe certifikime profesionale përkatëse, në përputhje me natyrën dhe kompleksitetin e kontratës, në kuptim të nenit 65 të LPP-së (Kriteret e përzgjedhjes dhe kualifikimit).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga GOE i shpallur fitues rezulton se ky i fundit nuk i ka përmbushur këto kriteret kualifikuese, pasi stafi i propozuar nuk dëshmon përvojë profesionale prej 10 vitesh pune dhe/ose nuk janë paraqitur certifikimet e kërkuara, ashtu siç janë përcaktuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit.

Pavarësisht kësaj mospërmbushjeje të qartë, GOE në fjalë është shpallur fitues, veprim ky që përbën shkelje të nenit 59 të LPP-së, i cili obligon AK-në që gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve të verifikojë përmbushjen e plotë të të gjitha kriterëve të kualifikimit të përcaktuara paraprakisht.

Një veprim i tillë bie gjithashtu ndesh me parimet themelore të prokurimit publik, të përcaktuara në nenin 1 dhe nenin 7 të LPP-së, përkatësisht parimin e trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit, transparencës dhe konkurrencës së ndershme ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Rrjedhimisht, vlerësojmë se vendimi për shpalljen e fituesit është marrë në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, pa u verifikuar dhe pa u përmbushur kriteret thelbësore të kualifikimit që ndërlidhen me përvojën dhe certifikimet e stafit profesional, çka e bën këtë vendim të pabazuar dhe ligjërisht të kontestueshëm.

#### Pretendimi 6

Nga dokumentacioni i ofertës rezulton se një pjesë e stafit kyç nuk përmbush kërkesat minimale për përvojë dhe kualifikim profesional, përfshirë:

Paraqitjen e dy personave në të njëjtin rol si Menaxher i Projektit, pa sqarim dhe pa përmbushje të qartë të kërkesës për përvojë minimale 10-vjeçare;

Mospërmbushjen e përvojës minimale prej 10 viteve nga disa anëtarë të stafit, bazuar në CV-të dhe referencat e paraqitura;

Paraqitjen e certifikatave për siguri dhe shëndet në punë nga institucione që nuk janë të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, në vend të certifikimeve të kërkuara nga MPMS dhe AME.

#### Pretendimi 7

Në vijim paraqesim stafin që nuk e përmbush përvojën 10-vjeçare të kërkuar.

Ylfete Tahiraj dhe Valon Elshani janë paraqitur si menaxherë të projektit, megjithatë asnjëri prej tyre nuk e përmbush kriterin e përvojës minimale 10-vjeçare të punës të kërkuar nga Dosja e Tenderit, pasi njëri ka vetëm 8 vite përvojë pune, ndërsa tjetri 7.5 vite.

#### Pretendimi 8

Nexhat Jashari – Arkitekt – nuk e përmbush kriterin e përvojës 10-vjeçare, pasi është diplomuar më 27.10.2015 dhe përvoja 10-vjeçare do të arrihej vetëm nëse ai do të kishte punuar pa ndërprerje që nga dita e diplomimit. Megjithatë, nga CV-ja e paraqitur rezulton se ai ka pasur ndërprerje prej dy vitesh, çka e redukton përvojën reale në rreth 8 vite pune.

Lidhur me pretendimet nr. 5, 6, 7 dhe 8, Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se pretendimet tona janë të pabazuara, duke arsyetuar se mangësitë në dokumentacionin e stafit profesional janë sqaruar përmes sistemit e-prokurimi dhe janë cilësuar si “mangësi të vogla”.

Megjithatë, ky qëndrim përbën trajtim të pabarabartë dhe zbatim selektiv të ligjit, pasi në rastin tonë AK ka eliminuar ofertën në tërësi për çështje të natyrës së njëjtë që lidhen me dokumentacionin e stafit profesional.

Në mënyrë kontradiktore, AK ka lejuar OE-në e rekomanduar të plotësojë dhe sqarojë mungesat lidhur me përvojën dhe certifikimet, ndërsa neve nuk na është dhënë e njëjta mundësi, edhe pse në rastin tonë bëhet fjalë vetëm për dy teknikë që realisht i plotësojnë kriteret.

Për më tepër, nga dokumentacioni i OE-së së rekomanduar rezulton se as Menaxheri i Projektit dhe as një pjesë e stafit tjetër profesional nuk e përmbushin kriterin e përvojës 10-vjeçare, çka përbën mosplotësim substancial të kriterëve kualifikuese.

Ky veprim përbën shkelje të nenit 7 dhe nenit 59 të LPP-së, si dhe të nenit 72 të LPP-së, pasi AK ka kërkuar sqarime vetëm nga OE i rekomanduar, ndërsa në rastin tonë ka aplikuar eliminim të menjëhershëm.

#### Pretendimi 9

Sa i përket inxhinierit të ndërtimtarisë – drejtimi hidroteknik, z. Lorik Dervishaj, i paraqitur si ekspert për siguri dhe shëndet në punë nga MPMS, konstatohet se certifikata e paraqitur nuk është e lëshuar nga MPMS, por nga kompania private “BLITERM”.

Kjo nënkupton se bëhet fjalë vetëm për trajnim profesional dhe jo për certifikim apo vendim për ekspert në kuptim të kërkesave të Dosjes së Tenderit.

Për këtë pikë ka ekzistuar edhe sqarim zyrtar nga AK, ku është theksuar se pranohen vetëm certifikatat ose vendimet e lëshuara nga MPMS, ndërsa certifikimet nga kompani private nuk pranohen.

Pavarësisht kësaj, AK nuk e ka trajtuar fare këtë pretendim në vendimin për rishqyrtim, duke u mjaftuar me një refuzim formal dhe pa arsyetim përmbajtësor, në kundërshtim me nenin 7 dhe nenin 59 të LPP-së.

#### Pretendimi 10

Në Dosjen e Tenderit është kërkuar një inxhinier i diplomuar në Mbrojtjen e Mjedisit (Master), i licencuar për hartimin e raporteve VNM, me së paku 5 vite përvojë pune.

GOE i shpallur fitues ka paraqitur z. Vehbi Goxhuli si inxhinier përgjegjës, megjithatë nga deklarata e noterizuar e tij rezulton se ai është në marrëdhënie pune primare me kompaninë “Ndërtimi Ing” Sh.P.K. dhe nuk ka dhënë autorizim për përdorimin e dokumentacionit të tij në këtë projekt nga kompania “Harst Group” Sh.P.K.

Kjo nënkupton se GOE i rekomanduar nuk e ka realisht në dispozicion këtë ekspert, duke mos përmbushur kriterin e kërkuar.

#### Pretendimi 11

Sa i përket z. Nikolla Dani, i paraqitur si hidroizolues, nga deklarata e tij e noterizuar rezulton se ai ka marrëveshje ekskluzive vetëm me kompaninë “Limit Project” Sh.P.K. për këtë procedurë dhe jo me kompaninë “Construmax” Sh.P.K.

Pavarësisht kësaj dëshmie, AK nuk e ka trajtuar këtë pretendim dhe e ka refuzuar pa arsyetim përmbajtësor.

#### Pretendimi 12

Konzorciumi fitues ka paraqitur një fasader me certifikatë nga Shqipëria, ndërkohë që kërkesa e Dosjes së Tenderit ka qenë që të paraqiten diploma dhe jo certifikata.

Në mënyrë kontradiktore, AK ka eliminuar operatorë të tjerë për të njëjtën arsye, ndërsa në këtë rast ka shpallur fitues një ofertues që nuk e përmbush këtë kriter, duke aplikuar standard të dyfishtë në kundërshtim me nenin 7 dhe nenin 59 të LPP-së.

Pretendimet 13–16

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se GOE i shpallur fitues nuk ka dëshmuar përmbushjen e kapaciteteve teknike, pasi:

Platforma ngritëse nuk përmbush lartësinë minimale prej 30 metrash;

Sistemi për ngritje me vakum nuk është i dokumentuar me specifikime teknike;

Marrëveshjet për përdorimin e pajisjeve janë të paqarta dhe nuk mundësojnë verifikimin e kapaciteteve.

Këto mangësi përbëjnë mospërmbushje të qartë të kriterëve teknike dhe profesionale dhe është dashur të rezultojnë me moskualifikimin e GOE-së.

Sqarim përfundimtar për OSHP

Për qëllime të qartësisë procedurale, theksojmë se kjo ankesë nuk paraqet zgjerim të objektit të kërkesës për rishqyrtim dhe nuk përmban pretendime të reja, por vetëm sqarime shtesë dhe elaborim juridik të pretendimeve ekzistuese.

Të gjitha shkeljet e pretenduara janë ngritur që në fazën e rishqyrtimit, ndërsa në këtë ankesë ato janë vetëm të detajuara dhe të lidhura me dispozitat përkatëse të LPP-së dhe praktikën e OSHP-së.

*-Pretendimet e operatorit ekonomik ankues ADA CONSULTING GROUP SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:*

Ankesa ka të bëjë me eliminimin e ofertës sonë në projektin e lartcekur, për të cilin konsiderojmë se ka shkelje të dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

Sipas letrës standarde B42 që kemi pranuar, ne jemi eliminuar për disa arsye, të cilat do t'i renditim me radhë duke ofruar edhe argumentet tona:

Arsyeja 1

“Ka ndërhyrje në formularin e paramasës në faqen numër 2; ka tekst të shënuar shtesë në komplet faqen, me hijezim apo përshkellime të ofertës.”

Arsyetimi 1

Siç mund të shihet në foton e bashkangjitur të paramasës në faqen dy, i gjithë teksti është i lexueshëm dhe i qartë. Nuk është bërë asnjë ndërhyrje, qoftë në përshkrime, sasi apo ndonjë element tjetër. Ajo që mund të vërehet është një përshkellim nga ana e printerit gjatë printimit, por që nuk e bën të palexueshme asnjë pjesë të ofertës. Pra, siç mund të shihet, nuk është bërë

asnjë ndryshim në tekst apo në numrat e sasive.

## Arsyeja 2

Kapaciteti teknik dhe profesional:

“Nuk ka prezantuar dëshmitë e kërkuara për stafin teknik minimal prej 40 punëtorësh. Ka prezantuar dëshmi vetëm për 21 punëtorë. Për stafin teknik nuk i ka të kompletuara certifikatat për siguri dhe shëndet në punë dhe mbrojtje nga zjarri.”

## Arsyetimi 2

Ne kemi prezantuar listën e punëtorëve së bashku me stafin teknik, gjithsej 41 persona të punësuar apo të angazhuar për këtë projekt. Për punëtorët e angazhuar kemi ofruar marrëveshje në emër të projektit, përmes së cilave, në rast se shpallemi të suksesshëm, ata do të angazhohen për realizimin e projektit. Punëtorët e tjerë janë pjesë e kompanisë. Nëse AK ka pasur ndonjë paqartësi, në përputhje me nenin 72 të LPP-së, është dashur të kërkojë sqarime.

## Arsyeja 3

“Për udhëheqësit e stafit teknik nuk janë kompletuar CV-të sipas kërkesave.”

## Arsyetimi 3

Në ofertën tonë kemi prezantuar 11 udhëheqës teknik me dëshmitë përkatëse. Edhe pse nuk janë ngarkuar të gjitha CV-të për shkak të volumit të madh të dokumentacionit, AK, në pajtim me nenin 72 të LPP-së, ka mundur të kërkojë sqarime dhe jo të eliminojë ofertën tonë, sidomos duke pasur parasysh se oferta jonë është rreth 270,000 € më e lirë.

## Arsyeja 4

“Z. Drenis Musliu është prezantuar si teknik i hidroteknikës, por ka diplomë tjetër; ndërsa Gresë Qorri nuk ka përvojë 5-vjeçare pas diplomimit.”

## Arsyetimi 4

Drenis Musliu është i diplomuar në profilin “Instalues i ujit, sanitare dhe sistemit të energjisë”. Ndërsa Gresë Qorri ka diplomuar Bachelor në nëntor 2014 dhe Master në nëntor 2020, prandaj plotëson kriterin e përvojës.

## Arsyeja 5

“Nuk ka prezantuar asnjë fasader.”

## Arsyetimi 5

Në ofertën tonë kemi prezantuar Jonuz Vinarcin si fasader, me certifikatë profesionale nga QAP.

## Arsyeja 6

“Tekniku Skender Hakolli nuk ka diplomë.”

## Arsyetimi 6

Z. Skender Hakolli posedon certifikatë profesionale nga një qendër e licencuar për aftësim profesional, e cila dëshmon aftësitë e tij në profesion.

Arsyeja 7

“Donart Thaqi nuk ka diplomë dhe CV.”

Arsyetimi 7

Për shkak të volumit të madh të dokumenteve, është bërë një lëshim teknik në ngarkimin e dokumenteve. AK ka mundur të kërkojë sqarime sipas nenit 72 të LPP-së.

Arsyeja 8

“Njomza Hoti nuk plotëson përvojën 10-vjeçare.”

Arsyetimi 8

Njomza Hoti është diplomuar në vitin 2014 dhe ka përvojë pune të vazhdueshme nga viti 2015 në kompani të ndryshme (URB Pro, NNT ABC, Ada Consulting Group, etj.), çka dëshmohet me referenca dhe CV.

Arsyeja 9

“Halil Bytyqi nuk ka certifikatë për siguri dhe shëndet në punë.”

Arsyetimi 9

Dokumentet janë dorëzuar, por për shkak të volumit është harruar certifikata. AK ka mundur të kërkojë sqarime.

Arsyeja 10

“Nuk është prezantuar inxhinier i elektroteknikës.”

Arsyetimi 10

Ne kemi prezantuar z. Agim Kastrati dhe dosja e tij është ngarkuar në sistem.

Arsyeja 11

“Shukri Krasniqi nuk ka kontratë.”

Arsyetimi 11

Bëhet fjalë për një gabim teknik në ngarkim të dokumenteve. AK ka mundur të kërkojë sqarim.

Arsyeja 12

“Inxhinieri i mjedisit nuk ka certifikata për siguri dhe zjarr.”

Arsyetimi 12

AK ka mundur të kërkojë sqarime sipas nenit 72 të LPP-së.

Arsyeja 13

“Inxhinieri i gjeodezisë nuk ka certifikata.”

Arsyetimi 13

Ne kemi prezantuar z. Xhavit Fetahu me certifikatë për siguri në punë. Për çdo paqartësi, AK ka mundur të kërkojë sqarime.

Arsyeja 14

“Nuk ka të paktën tre persona të certifikuar nga MPMS dhe AME.”

Arsyetimi 14

Ne kemi ofruar stafin me dokumentacion përkatës, përfshirë persona të certifikuar. Për çdo paqartësi, AK ka mundur të kërkojë sqarime.

Arsyeja 15

“Nuk ka ekspert të certifikuar për saldim.”

Arsyetimi 15

Ne kemi angazhuar z. Arsim Maloku si ekspert të certifikuar për saldim. Në rast mungese dokumenti, AK ka mundur të kërkojë sqarime.

Arsyeja 16

“Nuk është prezantuar pajisja për ngritje me vakum.”

Arsyetimi 16

Ne kemi prezantuar pajisjet e kërkuara, por për këtë pajisje specifike ka ndodhur një lëshim teknik në ngarkim. AK ka mundur të kërkojë sqarime.

Përfundim

Duke u bazuar në të gjitha sa u cekën më lart, Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të dispozitave ligjore duke mos trajtuar në mënyrë të barabartë ofertuesit. Shumica e arsyeve për eliminim janë çështje që kanë mundur të sqarohen lehtësisht përmes një kërkesë për sqarim, ashtu siç parashihet me nenin 72 të LPP-së.

Po ashtu, shumë nga këto devijime janë të vogla dhe të lejueshme sipas nenit 59 të LPP-së. Para se të merrte vendim për eliminim dhe rekomandim të një operatori ekonomik me ofertë më të lartë financiare, AK është dashur të kërkojë sqarime për të gjitha pikat dhe të bëjë një vlerësim sa më të drejtë dhe real të ofertave.

*-Pretendimet e operatorit ekonomik ankues NIKA PrO- Ing SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:*

**Komisioni i Vlerësimit gjatë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, përkatësisht me dispozitat ligjore të lartcekura dhe Rregulloren/Udhëzimin Operativ për Prokurim Publik.**

Autoriteti Kontraktues, me datë 16.01.2026, ka nxjerrë Njoftimin mbi Vendimin e AK-së, duke na eliminuar neve edhe pse jemi ofertues i përgjegjshëm me çmimin më të lirë, dhe duke rekomanduar për kontratë një Operator Ekonomik të papërgjegjshëm me çmim më të lartë për 123,161.12 €.

Veprimet e AK-së jo vetëm që janë të kundërligjshme, por tregojnë qartë edhe një qëllim diskriminues ndaj kompanisë sonë, duke cenuar parimet themelore të barazisë dhe konkurrencës së ndershme në prokurimin publik.

Megjithatë, në vijim do të argumentojmë në mënyrë të detajuar se konstatimi i AK-së për eliminimin tonë është i pabazuar dhe në kundërshtim me frymën e LPP-së dhe rregulloreve në fuqi.

Ne kemi analizuar Njoftimin mbi Vendimin e AK-së, ku kemi paraqitur në një rën anë gjetjet e AK-së dhe në anën tjetër përgjigjet tona si GOE për këtë aktivitet.

### **Pretendimi 1**

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet e cekura më lart, konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenet 59, 69 dhe 72 të LPP-së, pasi AK nuk ka kërkuar sqarime shtesë, edhe pse oferta jonë është e përgjegjshme.

Gjatë kësaj procedure të prokurimit, pas analizimit të dokumentacionit të OE të rekomanduar për kontratë, kemi vërejtur se i njëjti nuk ka vepruar me përgjegjësi të mjaftueshme dhe nuk ka arritur të përmbushë kërkesat e Dosjes së Tenderit (DT).

Në vijim paraqesim argumentet tona:

### **Pretendimi 2**

Operatori Ekonomik (OE) ose Operatorët Ekonomikë të Grupuar (GOE) duhet të dëshmojnë kapacitet financiar të mjaftueshëm, konkretisht të kenë së paku 1,000,000 € në asete likuide ose qasje të pakushtëzuar në kredi. Në rast të grupit, së paku 51% e këtij kapaciteti duhet të sigurohet nga lideri i grupit.

#### **Dëshmia:**

Duhet të dorëzohet deklaratë bankare origjinale që vërteton disponueshmërinë e mjeteve ose qasjen në kredi.

Në këtë rast, Autoriteti Kontraktues ka përdorur standard të dyfishtë, duke mos e marrë këtë kërkesë në konsideratë për anëtarin e konsorciumit të OE të rekomanduar.

### **Pretendimi 3**

Sipas Dosjes së Tenderit, OE/GOE duhet të dëshmojë përvojë në projekte të ngjashme në vlerë minimale prej 15,000,000 € gjatë tre viteve të fundit, si dhe të ketë realizuar së paku një projekt

spitalor me punime specifike (X-ray, gaz medicinal, ventilim, klimatizim, dyer automatike X-ray, etj.).

Operatori Ekonomik i rekomanduar nuk e plotëson këtë kërkesë, pasi edhe pas sqarimeve ka paraqitur vetëm paramasa të punëve që nuk përmbushin kriteret për projekte spitalore me specififikimet e kërkuara.

Punët e paraqitura nga OE nuk dëshmojnë realizim të projekteve që përfshijnë elementet e kërkuara si X-ray, gaz medicinal, ventilim dhe klimatizim, prandaj nuk përmbushin kriterin teknik dhe profesional.

#### **Pretendimi 4**

Në lidhje me pajisjet teknike, OE i rekomanduar ka ofruar pajisje për ngritje me vakum me kapacitet 600 kg, ndërsa kërkesa ka qenë deri në 500 kg.

Kjo përbën devijim nga specififikimet teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe nuk është në përputhje me kërkesën konkrete.

#### **Pretendimi 5**

Sipas kërkesës për staf teknik, OE duhet të paraqesë të paktën 40 persona me CV të nënshkuara.

Nga analiza rezulton se OE i rekomanduar ka vetëm 39 persona të angazhuar realisht si staf teknik. Gjithashtu, mungojnë CV-të e nënshkuara për një pjesë të stafit, duke e bërë dokumentacionin të paplotë dhe të papranueshëm.

#### **Pretendimi 6**

OE i rekomanduar nuk ka paraqitur vendime për emërimin e udhëheqësve të stafit teknik për të gjitha pozicionet e kërkuara.

Kjo është kërkesë administrative që duhet të përmbushet në momentin e dorëzimit të ofertës dhe nuk mund të plotësohet përmes sqarimeve shtesë.

#### **Pretendimi 7**

Autoriteti Kontraktues ka pasur obligim të verifikojë rastin e përdorimit të të njëjtit ekspert (z. Nikoll Dani) nga dy operatorë ekonomikë.

Ekzistojnë dyshime serioze për vlefshmërinë e certifikatave të paraqitura, pasi ato rezultojnë të lëshuara në të njëjtën kohë nga institucione të ndryshme, gjë që kërkon verifikim të domosdoshëm.

#### **Pretendimi 8**

Sipas kërkesës për inxhinier të mjedisit, OE i rekomanduar ka paraqitur kontratë me ing. Vehbi Goxhuli.

Megjithatë, bazuar në vendimin e OSHP-së nr. PSH1278/25, datë 19.01.2026, rezulton se i njëjti ka deklaruar se nuk ka pasur marrëveshje me asnjë OE tjetër.

Për rrjedhojë, kjo kërkesë nuk është përmbushur dhe oferta e OE të rekomanduar është e papërgjegjshme në këtë pikë.

## **Pretendimi 9**

Duke pasur parasysh afatin e shkurtër për rishqyrtim, pajtohem me konstatimet e Komisionit të Vlerësimit se edhe operatorët e tjerë ekonomikë janë të papërgjegjshëm.

## **Përfundim**

Nga të gjitha argumentet e lartcekura, rezulton qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i pabazuar dhe përbën arsyetim formal (blanko), pa trajtuar në mënyrë konkrete pretendimet tona.

Është fakt i pamohueshëm se ne i kemi përmbushur të gjitha kërkesat e Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit.

Në këtë rast, nëse Komisioni i Vlerësimit ka bërë gabim, Zyrtari i Prokurimit si autoritet vendimmarrës mban përgjegjësi të plotë për miratimin e një rekomandimi të paligjshëm.

Sipas neneve 59, 69 dhe 72 të LPP-së, Autoriteti Kontraktues ka pasur detyrim të kërkojë sqarime dhe plotësime të dokumentacionit. Mungesa e dokumenteve nuk duhet të jetë arsye për eliminim automatik pa shfrytëzuar këtë mundësi ligjore.

Kërkojmë që pretendimet tona të shqyrtohen seriozisht dhe të bëhet rishqyrtimi i vendimit në përputhje me dokumentacionin dhe praktikën e OSHP-së.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim për Acerler Insaat Taahot MadenCilik Muhedislik Nakliyat Ve Sarrafiye Tiic.LTD.Sti:

E kemi shqyrtuar Kërkesën tuaj për Rishqyrtim të datës 21.01.2026 dhe mund të konstatojmë se pretendimet tuaja ankimore janë të pabazuara; andaj, ne si AK-MSH mbesim pas Njoftimit mbi Vendimin e AK-së të datës 16.01.2026.

Gjithashtu, bazuar në kërkesën tuaj për rishqyrtim, përkatësisht lidhur me pretendimin tuaj për shkeljet e pretenduara nga AK-ja, konkretisht për nenin 40, ku në pikën 2 keni pretenduar: “Në vend se të përmirësojë apo kërkojë sqarime, ka anuluar procedurën pa arsyetim real ose domosdoshmëri ligjore”, konstatojmë se ky pretendim dhe, rrjedhimisht, kërkesa për rishqyrtim në këtë pjesë është paraqitur gabimisht dhe është e papranueshme/palejuar, për faktin se procedura e prokurimit nuk është anuluar nga Autoriteti Kontraktues dhe, si e tillë, kërkesa nuk mund të trajtohet mbi një bazë faktike dhe juridike që nuk ekziston.

Edhe pse kjo kërkesë për rishqyrtim konsiderohet e papranueshme/palejuar, ne si Autoritet Kontraktues, me qëllim të transparencës dhe qartësisht të plotë të çështjes, do të ofrojmë sqarimet e nevojshme lidhur me pretendimet e parashtruara, duke konstatuar se të njëjtat janë të pabazuara në fakte dhe në dispozitat përkatëse ligjore të LPP-së dhe rregullave të prokurimit.

Pretendimi 1: Sa i përket pretendimit në lidhje me gabimet në çmimin për njësi në paramasën tuaj të ofertuar, e konsiderojmë pretendim të pabazuar. Ne kemi vepruar drejt dhe bazuar edhe në praktikën e mëhershme të trajtuara në OSHP për këtë çështje, meqenëse janë evidente gabimet në tre pozicione të paramasës, siç janë përshkruar në B42 – Letër Standarde për tenderuesin e

eliminuar.

Ju keni gabuar në plotësimin e paramasës në çmimet për njësi në tre (3) pozicione, të cilat kanë qenë të përshkruara brenda pozicionit se cila shumë duhet të vendoset si çmim njësi, ndërsa ju gabimisht keni vendosur çmime që nuk janë në përputhje me përshkrimin e pozicionit:

Te pozicioni M3.30, në vend që të plotësohet çmimi njësi 918 euro, është plotësuar 1,285.20 euro.

Te pozicioni M5.19, në vend që të merret shuma e M5.16 prej 64,000.00 euro si çmim njësi, është marrë shuma e M5.18 prej 39,000.00 euro.

Te pozicioni M9.8, në vend që të jetë shuma 4,240 euro, si çmim njësi është marrë shuma 5,936 euro.

Këto janë gabime në kolonën e çmimeve për njësi dhe, si të tilla, e bëjnë ofertën të papërgjegjshme, meqenëse nuk janë gabime aritmetike dhe nuk mund të korrigjohen nga AK-ja sipas nenit 59.3 të LPP-së, e as nga OE të kërkoen ndryshime të çmimit njësi.

Bazuar në sqarimet e lartcekura, mbetet në fuqi arsyeja e eliminimit e përshkruar në B42 – Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar, të datës 16.01.2026.

Pretendimi 2: Sa i përket pretendimit në lidhje me arsyen e eliminimit tuaj për objektin spitalor, e konsiderojmë pretendim të pabazuar. Konsiderojmë se kemi vepruar drejt dhe bazuar në konstatimet e komisionit vlerësues të cekura në raportin e vlerësimit, ku janë evidentuar mangësi në dokumentacionin e ofertës suaj për këtë kërkesë, të cilat janë përshkruar në B42 – Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar:

Dokumentacioni i ofruar si dëshmi i kompanisë turke Acerler Insaat Taahut nuk dëshmon se ndonjëri nga projektet e kryera ka përfshirë punime të X-ray, gazra medicinale apo dyer automatike X-ray.

Nuk është prezantuar raport testimi për X-ray.

Është prezantuar një raport kalibrimi i pajisjeve, pa evidencë për projektin apo subjektin që e ka realizuar atë.

Bazuar në dëshmitë e ofruara nga oferta juaj, ju keni prezantuar një projekt për ndërtimin e një spitali për nevojat e Fakultetit të Stomatologjisë dhe Praktikës. Nga ky projekt kuptohet se objekti i shërben studentëve për praktikë dhe nuk janë ofruar dëshmi tjera për punimet e kërkuara. Në vend të raportit të testimit për X-ray, keni prezantuar një certifikatë kalibrimi, të cilën komisioni vlerësues me të drejtë nuk e ka marrë parasysh, duke e konsideruar si dëshmi që nuk përputhet me kërkesat e dosjes së tenderit.

Bazuar në dëshmitë e ofruara, nuk kemi pasur bazë për të kërkuar sqarime shtesë për këtë kriter, pasi që ju vetë nuk keni paraqitur dokumentin e kërkuar.

Gjithashtu, duhet theksuar se në të gjitha dëshmitë e përkthyer nga gjuha turke, përkthyesi ka deklaruar: “Nuk e marr përgjegjësinë për autenticitetin e dokumentit të sjellë nga pala”, gjë që i bën dokumentet më pak bindëse për AK-në.

Pretendimet 3, 4, 5, 6: Sa i përket mangësive në stafin teknik dhe profesional, këto pretendime konsiderohen të pabazuara. AK ka vepruar drejt bazuar në raportin e vlerësimit.

Ju vetë në pretendimin nr. 4 keni pranuar se znj. Florijona Osmanaj nuk e përmbush përvojën 5-vjeçare pas diplomimit. Referenca e dorëzuar më vonë nuk mund të merret parasysh, pasi sipas nenit 72.3 të LPP-së pranohen vetëm dokumentet ekzistuese para afatit të dorëzimit.

Për z. Sabit Bytyqi, dokumentet për siguri dhe mbrojtje nga zjarri nuk janë dorëzuar (fajllat janë bosh), prandaj nuk janë kërkuar sqarime shtesë.

Sa i përket z. Ekrem Tahiraj, certifikata e dorëzuar në ofertë nuk plotëson përvojën e kërkuar 5-vjeçare. Megjithatë, certifikata shtesë e dorëzuar me kërkesën për rishqyrtim pranohet si dëshmi shtesë dhe ky pretendim konsiderohet pjesërisht i bazuar.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim për ADA CONSULTING GROUP SH.P.K.,

Përgjigja e AK në lidhje me pretendimet ankimore të OE ankues

E kemi shqyrtuar Kërkesën tuaj për Rishqyrtim të datës 21.01.2026 dhe mund të konstatojmë se pretendimet tuaja ankimore janë të pabazuara; andaj, ne si AK-MSH mbesim pas Njoftimit mbi Vendimin e AK-së të datës 16.01.2026.

Pretendimi 1: Sa i përket pretendimit në lidhje me paramasën tuaj të ofertuar, e konsiderojmë pretendim të pabazuar. Konsiderojmë se kemi vepruar drejt, bazuar në konstatimet e komisionit vlerësues të cekura në raportin e vlerësimit, ku janë evidentuar mangësi në dokumentacionin e ofertës suaj për këtë kërkesë, siç janë përshkruar në B42 – Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar.

Pretendimi 2: Sa i përket pretendimit në lidhje me arsyen e eliminimit tuaj se nuk keni prezantuar dëshmitë e kërkuara për stafin teknik (minimum 40 punëtorë), siç është kërkuar, e konsiderojmë pretendim të pabazuar. Konsiderojmë se kemi vepruar drejt, bazuar në konstatimet e komisionit vlerësues të cekura në raportin e vlerësimit, ku janë evidentuar mangësi në dokumentacionin e ofertës suaj për këtë kërkesë, dhe edhe tani në fazën ankimore nuk keni ofruar dëshmi që e përmbushni këtë kërkesë të NJK dhe DT.

Pretendimi 3: Sa i përket pretendimit në lidhje me arsyen e eliminimit tuaj për mungesën e CV-ve të udhëheqësve teknikë, e konsiderojmë pretendim të pabazuar. Konsiderojmë se kemi vepruar drejt, bazuar në konstatimet e komisionit vlerësues të cekura në raportin e vlerësimit, ku është evidentuar mungesa e CV-ve në ofertën tuaj, dhe këtë e pohoni edhe vetë në kërkesën për rishqyrtim që nuk i keni prezantuar ato. Bazuar në dëshminë e kërkuar dokumentare – CV të nënshkruara nga vetë tekniku – meqenëse është kërkuar nënshkrimi nga vetë tekniku, nuk mund të kërkohet plotësimi i CV-ve pas hapjes së ofertave në fazën e vlerësimit, pasi nuk mund të vërtetohet nëse CV-ja e ofruar ka qenë e nënshkruar para hapjes së ofertave.

Pretendimi 4: Sa i përket pretendimit në lidhje me arsyen e eliminimit tuaj për teknikun e hidroteknikës, e konsiderojmë pretendim pjesërisht të bazuar, pasi që tani keni prezantuar kopjen e diplomës bachelor për znj. Gresa Qorri.

Pretendimi 5: Sa i përket pretendimit në lidhje me arsyen e eliminimit tuaj se nuk keni prezantuar asnjë teknik fasader, e konsiderojmë pretendim të pabazuar, pasi që në ofertë nuk keni prezantuar

asnjë fasader me diplomë, siç ka qenë kërkesa në DT: “Në kuadër të stafit teknik duhet të jetë së paku nga një udhëheqës për pozicionet kryesore të punimeve, të cilët duhet të jenë teknikë të diplomuar në shkolla të mesme dhe me përvojë së paku pesë vite pas diplomimit”. Gjithashtu, ky pretendim nuk është i bazuar as tani, pasi që me kërkesën për rishqyrtim keni prezantuar vetëm një certifikatë, ndërsa kërkesa ka qenë për diplomë të shkollës së mesme dhe jo certifikatë trajnimi.

Pretendimi 6: Sa i përket pretendimit në lidhje me arsyen e eliminimit tuaj për z. Skender Hakolli, e konsiderojmë pretendim të pabazuar, pasi që nuk keni prezantuar diplomë të shkollës së mesme, por vetëm certifikatë trajnimi. Kërkesa në DT ka qenë që teknikët të jenë të diplomuar në shkolla të mesme dhe me përvojë së paku pesë vite pas diplomimit. Në rast të paqartësive, keni mundur të kërkonit sqarime në fazën e tenderimit, para hapjes së ofertave. Kërkesat e DT kanë qenë transparente për të gjithë OE dhe ne si AK jemi të obliguar që vlerësimin ta bëjmë bazuar në dokumentet e prezantuara, me trajtim të barabartë dhe pa diskriminim.

Pretendimi 7: Sa i përket pretendimit në lidhje me arsyen e eliminimit tuaj për z. Donart Thaqi, për të cilin nuk keni prezantuar diplomë dhe as CV, e konsiderojmë pretendim të pabazuar. Konsiderojmë se kemi vepruar drejt, bazuar në konstatimet e komisionit vlerësues, ku është evidentuar mungesa e CV-së dhe diplomës në ofertën tuaj, dhe këtë e pohoni edhe vetë në kërkesën për rishqyrtim. Duke qenë se CV-ja është dashur të jetë e nënshkruar nga vetë teknikun, nuk mund të kërkohet plotësimi i saj pas hapjes së ofertave, pasi nuk mund të vërtetohet koha e nënshkrimit.

Neni 72.3 i LPP-së e specifikon qartë se sigurimi i informacionit që mungon lejohet vetëm për dokumente që kanë ekzistuar para afatit të dorëzimit të tenderëve dhe mund të verifikohen objektivisht.

Pretendimi 8: Sa i përket pretendimit në lidhje me znj. Njomza Hoti dhe përvojën e kërkuar prej 10 viteve pas diplomimit, ky pretendim është i pabazuar, pasi në CV-në e saj janë prezantuar vetëm 8 vite përvojë. Edhe vetë fakti që ju pranoni përvojë jashtë CV-së tregon se CV-ja nuk përmbush kërkesën; prandaj, komisioni vlerësues ka vepruar drejt, pasi në rastet kur CV-ja nuk përmbush kërkesat, tenderi duhet të refuzohet sipas udhëzuesit përkatës.

Pretendimi 9: Sa i përket pretendimit për z. Halil Bytyqi, i cili nuk ka prezantuar certifikata për siguri dhe shëndet në punë dhe për mbrojtje nga zjarri, e konsiderojmë pretendim të pabazuar, pasi edhe vetë ankuesi është pajtuar me këtë arsye eliminuese dhe nuk ka bashkangjitur këto certifikata as në fazën e rishqyrtimit.

Pretendimi 10: Sa i përket pretendimit për mungesën e inxhinierit të elektroteknikës, e konsiderojmë pretendim të pabazuar, pasi që z. Agim Kastrati është inxhinier i energjetikës dhe plotëson kërkesën 4.6, por nuk keni prezantuar inxhinier të elektroteknikës sipas kërkesës 4.7. Në DT kanë qenë dy kërkesa të ndara dhe ju keni plotësuar vetëm njërin.

Pretendimi 11: Sa i përket pretendimit për mungesën e kontratës për z. Shukri Krasniqi, e konsiderojmë pretendim të pabazuar, pasi edhe vetë keni pranuar gabimin teknik dhe nuk keni bashkangjitur kontratën as në fazën e rishqyrtimit.

Pretendimi 12: Sa i përket pretendimit për inxhinierin e mjedisit pa certifikata për siguri dhe mbrojtje nga zjarri, e konsiderojmë pretendim të pabazuar, pasi edhe vetë keni pranuar se kjo dëshmi është harruar dhe nuk është dorëzuar as në rishqyrtim.

Pretendimi 13: Sa i përket pretendimit për inxhinierin e gjeodezisë, e konsiderojmë pretendim të pabazuar, pasi nuk është dorëzuar certifikata për mbrojtje nga zjarri, por vetëm ajo për siguri dhe shëndet në punë.

Pretendimi 14: Sa i përket pretendimit për mungesën e së paku tre personave të certifikuar për siguri dhe mbrojtje nga zjarri, e konsiderojmë pretendim të pabazuar, pasi nuk janë dorëzuar dëshmi shtesë as në fazën e rishqyrtimit.

Pretendimi 15: Sa i përket pretendimit për mungesën e një eksperti të certifikuar për saldim, e konsiderojmë pretendim të pabazuar, pasi që vetë keni pranuar mungesën e këtij profili dhe nuk keni dorëzuar dëshmi përkatëse, përveç një certifikate nga një laborator.

Pretendimi 16: Sa i përket pretendimit për mungesën e pajisjes “Sisteme për ngritje me vakuum për xham, për elemente fasade deri në 500 kg”, e konsiderojmë pretendim të pabazuar, pasi nuk është dorëzuar asnjë dëshmi as në fazën e rishqyrtimit.

Bazuar në sqarimet e lartcekura, AK e konsideron Kërkesën tuaj për Rishqyrtim si të pabazuar dhe qëndron pas Njoftimit mbi Vendimin e AK-së të datës 16.01.2025.

-Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim për NIKA Pro- Ing SH.P.K.,

Kemi shqyrtuar kërkesat për rishqyrtim të OE “Global Holding” SH.P.K. dhe OE “NIKA Pro-Ing” SH.P.K. dhe konstatojmë se pretendimet tuaja ankimore janë të pabazuara.

Kërkesa për rishqyrtim e OE “NIKA Pro-Ing” SH.P.K. është jashtë afatit, meqenëse është paraqitur më datë 29.10.2025, ndërsa hapja e ofertave ka qenë e paraparë për datën 03.10.2025. Sipas llogaritjes së afateve, dita e dorëzimit të ofertave (03.10.2025) konsiderohet dita zero (0), në përputhje me nenin 60.1 (a).

Ndërsa, sipas llogaritjes së bërë nga OE, data 29.10.2025 është konsideruar dita zero (0), dhe më pas: 30.10.2025 dita e parë, 31.10.2025 dita e dytë, 01.11.2025 dita e tretë dhe 02.11.2025 dita e katërt.

Sipas Rregullores nr. 001/2022, neni 60 – Parashtrimi i kërkesës për rishqyrtim dhe afatet kohore, pika (a), kur kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit, ajo duhet të paraqitet së paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzimin e ofertave. Ky afat nuk aplikohet në rastet kur Autoriteti Kontraktues bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave pas vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, sipas nenit 63.1.1 të kësaj rregulloreje.

Sipas Rregullores nr. 002/2024, neni 63.2 – Vendimi i Autoritetit Kontraktues, në rastet kur zyrtari përgjegjës i prokurimit nuk nxjerr vendim lidhur me kërkesën për rishqyrtim dhe nuk njofton operatorin ekonomik për afat shtesë, operatori ekonomik ka të drejtë të parashtrijë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit pas skadimit të afatit prej tre (3) ditësh pune nga data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim.

Gjithashtu, kërkesa për rishqyrtim e OE “NIKA Pro-Ing” SH.P.K., në vendimin në faqen 4, i referohet OE “ENG BAU” SH.P.K., që është kompani tjetër dhe nuk ka të bëjë me këtë operator ekonomik.

Raportin e ekspertizës me nr.0069/2026 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është pajtuar rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, OE nuk është pajtues rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Raportin e ekspertizës me nr.0073/2026 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është pajtues rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, OE nuk është pajtues rreth raportit të ekspertit shqyrtues. Raportin e ekspertizës me nr.0074/2026 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është pajtues rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk është pajtues rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit shqyrtues, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesve, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

-Lidhur me pretendimet e OE Acerler Insaat Taahot Madencilik Muhendislik Nakliyat Ve Sarrafiye Tiic.LTD.Sti, eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0069 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i pakënaqur me Vendimin (B58) të AK-së, për dhënie të kontratës, ka parashtruar ankese në OSHP, me pretendimin se AK/Ministria e Shëndetësisë nuk e ka bërë vlerësimin e ofertave duke u bazuar në dispozitat e LPP-së.

Autoriteti kontraktues pas përfundimit të vlerësimit të ofertave e njofton OE ankues me letrën standarde të tenderuesit të eliminuar.

OE ankues eliminohet me arsyetimin si më poshtë:

Lidhur me arsyen e parë të eliminimit të OE ankues, sa i përket gabimit në çmimet për njësi, eksperti shqyrtues fillimisht sqaron se OE ankues në parametere ka vendosur gabimisht çmimet për njësi si më poshtë:

Te pozicioni i përshkruar si më lartë, OE ankues ka vendosur çmimin për njësi 1,285.20 ndërsa është dashur të vendoset 918.00€, njësoj ka vepruar edhe në dy pozicione tjera.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues në ankesën e tij të dorëzuar në OSHP pretendon se kemi të bëjmë me gabime aritmetike, pra sipas OE ankues autoriteti kontraktues është dashur të korrigjojë dhe të vazhdojë me tutje.

Eksperti shqyrtues vlerëson se nuk qëndron pretendimi i OE ankues, sepse në rastin konkret kemi të bëjmë me ndryshim të çmimit për njësi i cili sipas dispozitave të Nenit 59 të LPP-se, nuk lejohet.

Konkretisht, në pozicionin e përshkruar si me larte, kur merret 10% e pozicionit M3.28.1 dhe M3.28.5 atëherë çmimi për njësi në këtë pozicion rezulton të jetë 918.00€ dhe nuk del të jetë 1,285.50€ siç e ka përshkruar në paramasë OE ankues. Andaj, eksperti sqaron se korrigjimi i çmimit për njësi siç u sqarua edhe me larte, nuk lejohet sipas dispozitave të nenit 59 të LPP-së.

Lidhur me arsyen e eliminimit të OE ankues se nuk ka ofruar dëshmi – raport të testimi X ray, por ka dorëzuar raport të kalibrimit të pajisjes, eksperti shqyrtues, sqaron se AK/MSH, në dosje të tenderit të kërkesa-dëshmia nr. 2 ka kërkuar i me poshtë:

Dëshmia 2. - Një Listë të projekteve të realizuara, Origjinal e vulosur dhe e nënshkruar. Lista duhet t'i ketë këto të dhëna - Titulli i kontratës, - Investitori, - Të dhënat e personit kontaktues, - Datën e fillimit dhe të përfundimit të projektit, - Vlerën e projektit. Konsiderohen të vlefshme vetëm listat me të dhënat e lartcekura. Për çdo projekt të realizuar kërkohet Referencë ose Procesverbal i Pranimit teknik (për investitor privat AK mund t'i verifikoj transaksionet financiare). Për eksperiencën (lidhur me X-ray, Gaz medicinal, ventilim, klimatizim, dyer X-ray Automatike, etj ) duhet të prezantohet së paku një raport i testimi për X-ray.

Bazuar në dëshminë e dorëzuar nga OE ankues në ofertën e tij, i cili ka dorëzuar dëshmi të kalibrimit të pajisjes dhe nuk ka dorëzuar raport të testimi X ray, eksperti sqaron se dëshmia nuk është në përputhje me kërkesën e dosjes së tenderit të cituar me larte. Megjithatë eksperti shqyrtues vlerëson se AK, është dashur të sqarohet duke u bazuar në nenin 72 të LPP-së.

Lidhur me përvojën e teknikut të arkitekturës (E. Berisha), që sipas arsytimit të AK, nuk ka përvojën 5 vjeçare të kërkuar sepse sipas CV-se i njëjti ka përvoje prej 02.11.2020. Eksperti shqyrtues, sqaron se qëndron arsytimi i dhënë në letrën standarde nga ana e autoritetit kontraktues, sepse sipas dëshmimeve përvoja si teknike të arkitekturës ka filluar vetëm nga data 02.11.2020. Poashtu eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues në ankesën e tij i ka përmendur disa projekte të vitit 2019, mirëpo të njëjtat nuk mund të merren parasysh sepse përvoja profesionale llogaritet vetëm pas diplomimit. Data e diplomimit të teknikut (E. Berisha) është Qershor 2020, ndërsa sipas CV-se, projekti i parë që i merret si përvojë pune profesionale është data 02.11.2020.

Sa i përket arsyes së eliminimit, të OE ankues lidhur me përvojën e teknikut të IT-se (F. Osmanaj), që sipas AK-se, ka përvojë pune vetëm 3 vite, eksperti shqyrtues, sqaron se bazuar në dëshmitë e dorëzuara në oferte të OE ankues, përvoja e punës është siç e ka dhënë edhe AK në letrën standarde.

Lidhur me arsyen e eliminimit të OE ankues, që ka të bëjë me dëshmitë për të paktën tre persona të cilët duhet të jenë të certifikuar nga MPMS (MFPS) për siguri dhe shëndet në punë dhe nga AME për mbrojtje ndaj zjarrit dhe për këtë kërkesë AK ka kërkuar:

Për stafin e paraqitur nga pika 4.3 deri në pikën 4.10, stafi inxhinierik duhet të posedojë certifikatat e trajnimit për siguri dhe shëndet në punë, për mbrojtje nga zjarri, ku nga stafi i paraqitur të paktën tre persona duhet të jenë të certifikuar nga MPMS (MFPS) për siguri dhe shëndet në punë dhe nga AME për mbrojtje ndaj zjarrit..

Sipas vlerësimit të dhënë në letrën standarde, OE ankues i ka dorëzuar dëshmitë sipas kërkesës vetëm për dy inxhinierë (M. Kabashi dhe N. Merovci). Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues në ofertën e tij në ( follderin 7.1 i emërtuar si stafi i inxhinierëve), janë dorëzuar edhe dëshmitë e

inxhinierit S. Bytyqi, mirëpo follderi me numër rendore 2 dhe 3 janë të zbrazet (vetëm flet e bardh e skanuar), andaj marre parasysh këtë rezulton se OE ankues nuk i ka dorëzuar dëshmitë sipas kërkesës se dosjes se tenderit.

Sa i përket arsyes se eliminimit që ka të beje me mungesën e përvojës 5 vjeçare të salduesit, që sipas AK-së, certifikata është e lëshuar me datën 24.01.2024 dhe i njëjti nuk e plotëson kërkesën e dosjes se tenderit. Eksperti shqyrtues, sqaron se AK ne vendimin e kërkesës për rishqyrtim e ka pranuar se salduesi e plotëson kërkesën lidhur me përvojën e punës.

Sqarimi i dhënë nga AK ne Vendimin e kërkesës për rishqyrtim:

Certifikatën tjetër që e keni prezantuar se bashku me kërkesën për rishqyrtim, nga AQS cert për z. Ekrem Tahiraj, e lëshuar me datën 23.10.2020 me afat skadence deri me 22.10.2023, (edhe pse si dokument nuk është shume bindes krahasuar me certifikatën e ofertës) po e pranojmë si dëshmi shtese dhe pretendimin nr. 6 si pjesërisht të bazuar.

OE ankues, ne aneksen tij pretendon se i rekomanduari pre kontratë, nuk është i përgjegjshëm ku pretendon se kompania “Construmax” Sh.p.k. ka paraqitur si person të autorizuar znj. Bege Krasniqi. Megjithatë, autorizimi i paraqitur për këtë person rezulton i paplotë dhe i mangët, pasi nuk e specifikon qartë të drejtën për përfaqësim të plotë, përfshirë nënshkrimin dhe dorëzimin e dosjes së tenderit.

Eksperti shqyrtues, vlerëson se nuk qëndron pretendimi i OE ankues pasi që autorizimi për ( B. Krasniqi) i përmban të gjitha elementet për përfaqësim të operatorit ekonomik deri në nënshkrim të kontratave.

OE ankues pretendon se deklarata për themelimin e grupit të Operatorëve Ekonomikë të rekomanduar për kontrate nuk përmban të dhënat e plota të personit të autorizuar dhe nuk është e pajisur me vulën e kërkuar, duke e bërë këtë dokument të paplotë dhe të papërputhshëm me kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Eksperti shqyrtues, vlerëson se nuk qëndron pretendimi i OE ankues sepse deklarata për themelimin e grupit të Operatorëve Ekonomikë i përmban të gjitha elementet e kërkuara sipas formularit standarde të aprovuar nga KRPP.

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontrate nuk ka përmbushur kërkesën financiare për vlerën e letrës së përkrahjes/garancisë bankare, pasi është paraqitur një vlerë prej 980,000.00 EUR, ndërkohë që Dosja e Tenderit ka kërkuar shprehimisht vlerën minimale prej 1,000,000.00 EUR. Mungesa prej 20,000.00 EUR përbën mos-përmbushje të një kriteri eliminues financiar dhe, si e tillë, oferta nuk mund të konsiderohet e përgjegjshme në kuptim të Nenit 59 të LPP-së.

Pas ekzaminimit të të gjitha dëshmime lidhur me kërkesën e dosjes se tenderit, eksperti shqyrtues sqaron se dëshmitë e dorëzuara janë sipas kërkesës se dosjes se tenderit dhe vlera e ofruar e kalon 1,000,000.00 €.

OE ankues pretendon se konzorciumi i rekomanduar për kontrate nuk e plotëson kërkesën e dosjes se tenderit lidhur me kontrata dhe referenca.

Kërkesa 2. OE ose GOE duhet të dëshmoj se ka realizuar me sukses projekte te ngjashme-ndërtim ose renovim i objekteve, në vlerë të përgjithshme jo me pak se 15 Milion Euro, gjatë periudhës se shkuar tre vjeçare nga Njoftimi për Kontratë. Në rast të grupit te OE, së paku 51% e

punëve të përfunduara kërkohet për liderin e grupit. OE ose GOE duhet të dëshmoj se gjatë përvojës së tij në fushën e ndërtimit ka të përfunduar së paku një projekt spitalor me vlerë të madhe (kërkohet për liderin në rast të grupit), ku të jenë kryer punime lidhur me X-ray, Gaz medicinal, ventilim, klimatizim, dyer X-ray Automatike, etj. (Projektet mund të jenë të filluara edhe me herët por duhet të jenë të përfunduara gjatë periudhës së kaluar 3 vjeçare nga Njoftimi për Kontratë).

Eksperti shqyrtues, sqaron se AK, gjatë vlerësimit të ofertave ka kërkuar sqarime shtese lidhur me kontratat dhe referencat e OE të rekomanduara për kontrate dhe në përgjigje të tij OE i rekomanduar për kontrate i ka ofruar sqarimet e kërkuara nga autoriteti kontraktues, me të cilat ka arritur të dëshmoj se i njëjti e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontrate lidhur me referencat e kërkuara sipas kërkesës së cituar me lartë dhe për shkak të volumit të madh të shkresave të lëndës eksperti shqyrtues nuk mund të bashkëngjisë mirëpo të njëjtat dëshmi gjendet të ngarkuara në platformën e e-prokurimit.

OE ankues, pretendon se i rekomanduari për kontratë nuk e plotëson kërkesën për menaxher të projektit pasi ka prezantuar dy menaxhere dhe nuk ka ofruar dëshmi sipas kërkesave të dosjes së tenderit. Eksperti shqyrtues, vlerëson se nuk qëndron ky pretendim sepse menaxher i projektit, është i caktuar me Vendim ( V. Elshani )dhe për të njëjtin ka ofruar të gjitha dëshmitë sipas kërkesës së dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontrate.

OE ankues pretendon se Nexhat Jasharin – Arkitekt, nuk e përmbush kriterin 10 vite përvojë pune, pasi që diplomimi i tij është bërë me 27.10.2015 dhe përvoja e tij 10 vjeçare ishte llogaritur nëse ai do të punonte që nga dita e parë e diplomimit. Lidhur me këtë pretendim eksperti shqyrtues, sqaron se përveç inxhinierit të lartpërmendur OE i rekomanduar për kontratë, ka ofruar edhe disa arkitekt të tjerë e të cilët e përmbushin kërkesën e dosjes së tenderit, në rastin konkret ka ofruar edhe (Y. Tahiraj) e cila ka mbi 16 vite përvojë pune si inxhinierë e arkitekturës.

OE ankues pretendon se inxhinieri i ndërtimit – drejtimi hidroteknik z.Lorik Dervishaj, këtë inxhinier konzerciumi fitues e ka paraqitur si ekspert nga MPMS, por certifikata e prezantuar nuk është nga MPMS por nga Kompania “Bliterm”, që i bje që inxhinieri nuk është i kualifikuar si ekspert për siguri dhe shëndet në punë nga MPMS por nga një kompani private. Lidhur me këtë pretendim, eksperti shqyrtues, sqaron se sipas certifikatës kompania Bliterm është e certifikuar sipas Ligjit Nr. 04/L-161, për siguri dhe shëndet në punë.

OE ankues pretendon se inxhinieri Vehbi Goxhuli, i prezantuar si staf i OE të rekomanduar për kontrate, nuk është pjesë e konzorciumit të rekomanduar për kontrate duke pretenduar se i njëjti ka dhënë edhe deklaratë se është i angazhuar vetëm të OE Ndërtimi Ing dhe sipas informacioneve të cilat Vehbi Goxhuli i ka dhënë në deklaratën nën betim tek noteri, ai punon vetëm tek kompania Ndërtimi, kurse me kompani të tjera ka marrëveshje për projekte të caktuara. Konkretisht, në këtë rast nuk ka marrëveshje për këtë projekt. Në këtë pikë shpresojmë që OSHP ta vlerësojë njëjtë si në Komunën e Drenasit. Po ashtu nëse vërtetohet ky pretendim i joni nga ana e OSHP-së atëherë i bje që konzerciumi i shpallur fitues nuk i ka inxhinierin me MPMS, AME dhe VNM.

Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të gjithë dëshmimeve, sqaron se Inxhinieri i lartpërmendur, në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë e ka dorëzuar një kontratë të noterizuar në të cilën thuhet se kontrata me afat të caktuar është nënshkruar në prani të noterit nga inxhinieri V. Goxhuli. Andaj, eksperti shqyrtues, vlerëson se dëshmitë janë sipas kërkesës së dosjes së

tenderit.

Poashtu eksperti shqyrtues, sqaron se Inxhinieri (V. Goxhuli), ka dhënë edhe një deklaratë tjetër te noteri me të cilën është emëruar si deklaratë korrigjuese dhe ne këtë deklaratë inxhinier V.Goxhuli ka deklaruar si me poshtë:

Poashtu OE ankues pretendon se Konsorciumi i shpallur fitues, në listën e stafit të paraqitur, ka deklaruar z. Nikolla Dani si hidroizolues. Megjithatë, i njëjti ka dhënë një deklaratë të noterizuar, në të cilën konfirmon se dokumentacionin për këtë procedurë tenderuese ia ka dorëzuar ekskluzivisht kompanisë 'Limit Project' Sh.P.K. dhe jo kompanisë 'Construmax' Sh.P.K. Në deklaratën e tij, ai thekson se për këtë procedurë ka marrëveshje vetëm me kompaninë 'Limit Project' Sh.P.K. dhe se nuk ka asnjë marrëveshje apo dakordim me ndonjë kompani tjetër

Eksperti shqyrtues, sqaron se dëshmitë e teknikut të lartpërmendur janë sipas kërkesave të dosjes se tenderit, ndërsa sa i përket çështjes se nuk është pjese e stafit të konzorciumit, eksperti shqyrtues sqaron se i njëjti person ka edhe kontrate me OE Construmax, të nënshkruar nga N. Dani dhe i njëjti siç është cituar me larte, e ka korrigjuar deklaratën paraprake.

OE ankues, pretendon se Konzorciumi fitues ka paraqitur një fasader me certifikatë nga Shqipëria, pra kjo certifikatë nuk është e pranueshme pasi që kërkesa është: që duhet të jetë dhe pranohen vetëm diplomat. eksperti shqyrtues, sqaron se me rastin e aplikimit ne këtë aktivitet të prokurimit, i rekomanduari për kontratë ka dorëzuar diplomën sipas kërkesës se dosjes se tenderit.

OE ankues pretendon se nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga GOE i shpallur fitues, rezulton se ky i fundit nuk ka dëshmuar përmbushjen e kapaciteteve teknike të kërkuara, për arsyet në vijim: • Platforma ngritëse e paraqitur nuk përmbush lartësinë minimale të kërkuar prej 30 metrash, ashtu siç është përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

Eksperti shqyrtues, sqaron se nuk qëndron pretendimi i OE ankues sepse i rekomanduari për kontratë i ka dorëzuar dëshmitë sipas kërkesës se dosjes se tenderit.

OE ankuese, pretendon se i rekomanduari për kontrate nuk e ka plotësuar kërkesën, për Sistem për ngritje me vakum për xham dhe elemente fasade nuk është dëshmuar në përputhje me kapacitetin minimal të kërkuar, pasi mungojnë specifikimet teknike dhe dokumentacioni mbështetës që vërteton përmbushjen e këtij kriteri.

Eksperti shqyrtues, sqaron se dëshmitë janë sipas kërkesës se dosjes se tenderit.

Poashtu OE ankues lidhur me pajisjet pretendon se Marrëveshjet për përdorimin e pajisjeve të paraqitura nga OE nuk janë të detajuara dhe nuk specifikojnë qartë llojet e pajisjeve, kapacitetet përkatëse dhe disponueshmërinë e tyre, duke e bërë të pamundur verifikimin e përmbushjes së kërkesave teknike.

Eksperti shqyrtues sqaron se nuk qëndron ky pretendim i OE ankues, sepse marrëveshjet për shfrytëzimin e pajisjeve janë të nënshkruara dhe të hartuara qarte.

Eksperti shqyrtues, në fund vlerëson se autoriteti kontraktues e ka respektuar në tërësi Nenin 59 të LPP-së, sepse oferta e OE ankues, ka një gabim i cili nuk mund të korrigjohet sipas dispozitave të nenit 59 të LPP-së, për shkak të gabimit në çmim për njësi.

-Lidhur me pretendimet e OE ADA CONSULTING GROUP SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0073 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i pakënaqur me vendimin (B58) të Autoritetit Kontraktues/ Ministria e Shëndetësisë për dhënie të kontratës, ka parashtruar ankese ne OSHP, me pretendimin se AK nuk e ka bere vlerësimin e ofertave duke u bazuar në dispozitat e LPP-së.

Autoriteti kontraktues pas përfundimit të vlershmit të ofertave e njofton OE ankues me letrën standarde të tenderuesit të eliminuar.

OE ankues eliminohet me arsyetimin si me poshtë:

Lidhur me arsyen e pare të eliminimit, ku AK pretendon se OE ankues ka ndërhyrë në paramase, konkretisht në faqen nr. 2 të paramases, eksperti shqyrtues vlerëson se nuk qëndron ky arsyetim i dhënë nga AK-se, për fakti se nuk ka ndërhyrje ne tekst apo ndonjë ndryshim ne sasi apo në çmimin për njësi. Kjo mund të konstatohet si një gabim teknik gjate shtypjes se fletëve të paramases dhe njeherit eksperti sqaron se sa i përket kësaj pike gjithçka është e lexueshme dhe se shihet qartë.

Lidhur me arsyen e dyte të eliminimit, ku AK pretendon se nuk ka ofruar dëshmi për kërkesën nr. 3 ku nga AK janë kërkuar min. 40 punëtor, me profilin teknik te punëtorit.

OE ankues pretendon se ne kemi prezantuar listën e punëtove së bashku me teknik gjithsej me total prej 41 të punësuar apo angazhuar për këtë projekt, për punëtoret qe janë angazhuar për këtë projekte, është ofruar marrëveshje ne emër te projektit përmes se cilës ne rast se dalim te suksesshëm ata do te angazhohen si staf për realizimin e projektit, punëtoret tjerë janë pjese e kompanisë dhe nëse AK ka pas ndonjë dyshim ne lidhje me këtë është dashur qe konform akteve ligjoret qe parashihen me LPP, neni 72 të kërkoj sqarime.

Eksperti shqyrtues, lidhur me këtë pretendim sqaron se OE ankues nuk e ka plotësuar kërkesën e dosjes se tenderit, sepse dëshmia ne lidhur me kërkesën nr. 3 të AK-se është kërkuar:

Dëshmia 3. - Lista e stafit min. 40 punëtor, me profilin teknik te punëtorit,

– Kontratat ose marrëveshjet e punës për këtë projekt.

Ne rastin konkret eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i ka ofruar 21 kontrata të punës me stafin teknik. Andaj nuk qëndron pretendimi i OE ankues.

Sa i përket eliminimit, lidhur me atë se CV-it e stafit teknik udhëheqës, nuk janë te kompletuara, eksperti shqyrtues, vlerëson se nuk qëndron ky pretendim i AK-se, sepse është dashur të specifikohet qarte se çfarë mungon ne CV-it e stafit teknik ku janë kërkuar numër i madh i stafit teknik. Prandaj, nuk qëndron ky arsyetim i AK-se.

Lidhur me teknikun e hidroteknikes, eksperti shqyrtues, vlerëson se OE ankues e ka plotësuar kërkesën e dosjes se tenderit, me diplomën e (D. Musliut) sepse ne diplomë thuhet se është instalues i ujit, sanitarise dhe sistemeve të energjisë, i diplomuar ne vitin 2018, fakt te cilin e ka pranuar edhe vet AK ne vendimin e kërkesës për rishqyrtim.

Sa i përket kërkesës për fasader, për te cilin autoriteti kontraktues pretendon se OE ankues nuk ka ofruar dëshmi, eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues pretendon se ne ofertën tone kemi

prezantuar si fasader (Jonuz Vinarcin) si edhe mund te shihni ne foto certifikatën e aftësimit profesional lëshuar nga QAP.

Eksperti shqyrtues, vlerëson se kërkesa për fasader, nuk është plotësuar nga OE ankues për faktin se OE ankues ka ofruar certifikate të trajnimit dhe nuk ka ofruar dëshmi sipas kërkesës se dosjes se tenderit, ku nga AK është kërkuar: Diplomat e shkollës se mesme profesionale (pranohen edhe me Diploma bachelor).

Lidhur me dëshmitë për hidroizoluesin, eksperti shqyrtues, vlerëson se OE ankues njëjtë sikurse te kërkesa për fasader, OE ankues ka ofruar vetëm certifikate dhe nuk ka ofruar diplomë ashtu siç kërkohet me dosje te tenderit.

Sa i përket teknikut D. Thaqi, OE ankues pretendon se si shkak i volumit te dokumenteve është harruar qe te bashkëngjitet dokumentacionin për Donart Thaqin, por AK ne mënyrë qe te beje vlerësim sa me real dhe ne pajtim me nenin 72 ka mundur te kërkoj sqarime dhe do ua dërgomi siç edhe mund te shihni dilemën te bashkangjitur me poshtë. Lidhur me këtë pretendim eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues ne ankesën e tij e ka bashkangjitur diplomën për ( D. Thaqit), mirëpo CV nuk e ka dorëzuar dhe ne aneksen e tij nuk ka ofruar asnjë fakt lidhur me këtë çështje.

Lidhur me Udhëheqësen kryesore te punishtes znj. Njomza Hoti, qe sipas AK-se, nuk e plotëson përvojën 10 vjeçare pasi qe ka diplomuar ne 2014 dhe ne baze te dhënave te vete saj ne CV (e cila është e pa nënshkruar nga punëdhënësi) është evidentuar qe ka përvojë me pak se 8 vite (Shtator2016-vazhdon OSHP, por nuk ka reference). OE ankues pretendon se Njomza Hoti ka diplomuar ne vitin 2014 dhe është punësuar ne vitin 2015 (te evidentuar ne CV e saj dhe përcjell me referenca) ne kompaninë URB Pro nga viti 2015 deri ne gusht te vitit 2018. Eksperti shqyrtues, mbi bazën e dëshmive te ofruara për menaxheren e punishtes, vlerëson se janë kontradiktore, dhe është dashur te kërkohen sqarime mbi bazën e nenit 72 te LPP-se, sepse sipas referencave e plotëson ndërsa ne CV nuk janë paraqitur te gjitha këto të dhëna.

Sa i përket eliminimit, lidhur me Inxhinierin e diplomuar i ndërtimtarisë z.Halil Bytyqi, qe sipas AK-se, nuk ka te prezantuar certifikate qe ka kryer trajnim për siguri, shëndet ne pune e as trajnim për mbrojtje ndaj zjarri.” OE ankues pretendon se për inxhinierin ne fjale kemi dorëzuar dokumentet e kërkuar por si shkak i volumit është bere një lëshim teknik kur është harruar certifikata ne fjale prandaj AK përmes kërkesës për sqarime leht ka pas mundësi te vërtetoj edhe këtë.

Eksperti shqyrtues, sqaron se ne ofertën e OE ankues nuk është dorëzuar certifikatën e sigurisë dhe shëndetit ne pune, këtë e pranon edhe vet OE ankues ne ankesën e tij te parashtruar ne OSHP.

Lidhur me Inxhinierin e diplomuar i elektroteknikes, ku AK-ja pretendon se nuk ka te prezantuar ne oferte fare dhe OE ankues pretendon se ne kemi prezantuar z.Agim Kastrati dhe kemi ngarkuar dosjen e tij kjo dëshmohet përmes formularit te cilin e gjeneron sistem i prokurimit.

Eksperti shqyrtues, sqaron se nuk qëndron pretendimi i OE ankues, sepse diploma e (A. Kastratit) është diplomë e inxhinierit të diplomuar të energjetikes dhe se nuk e përmbush kërkesën 4.6 të AK-se sepse në kërkesën 4.7 të dosjes se tenderit është kërkuar- “Një Inxhinier (Master) i diplomuar i Elektroteknikes.

Sa i përket Inxhinierit të makinerisë z.Shukri Krasniqi, i cili sipas AK-se nuk ka te prezantuar kontrate mirëpo është prezantuar kontrata e z.Halil Bytyqi. OE ankues pretendon se ne këtë rast ka ndodh një gabim teknik, dosja është dorëzuar për Shukri Kraniqin por ka ndonjë një ngatërrim ne lidhje me kontratën, por AK me një kërkesë për sqarim do te merrte nga ana jone kontratën ne fjale.

Eksperti shqyrtues, sqaron se qëndron arsytimi i dhënë nga AK sepse OE ankues nuk ka ofruar kontratë për inxhinierin e lartpërmendur dhe njeherit eksperti shqyrtues sqaron se sipas dispozitave te nenit 72.3 të LPP-se, verifikimi i kësaj kontrate se a ka ekzistuar para hapjes, objektivisht nuk është i mundur.

Lidhur me inxhinierin e mjedisit, ku AK ka deklaruar se nuk ka te prezantuar certifikatën qe ka kryer trajnime ne siguri, shëndet ne pune e as trajnim për mbrojtje nga zjarri. OE ankues edhe ne këtë rast deklaroi AK ne këtë rast ne mënyre qe te beje vlerësim sa me te drejt duke përdorur nenin 72 te LPP ka mundur te kërkoj sqarime ne lidhje me certifikatat ne fjale qe si shkak i vulumit te madhe te dokumenteve janë harruar.

Eksperti shqyrtues, vlerëson se qëndron arsytimi i dhënë nga autoriteti kontraktues sepse i njëjti nuk ka dorëzuar certifikatën e lartpërmendur.

Sa i përket Inxhinierit të Gjeodezisë, qe sipas AK-se nuk ka te prezantuar certifikatën qe ka kryer trajnime ne siguri, shëndet ne pune e as trajnim për mbrojtje nga zjarri. OE ankues pretendon se dëshmitë e Gjeodetit ne kemi i prezantuar z.Xhavit Fetahu dhe gjithashtu e kemi bashkangjitur edhe certifikate për siguri ne pune e cila ka qene e bashkangjitur me dosjen e tij.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues e ka dorëzuar certifikatën e lartpërmendur të lëshuar nga një institucion privat, por qe sipas te dhënave është i licencuar pran MPMS-se.

Lidhur me arsyen e eliminimit se OE ankues nuk ka te prezantuar te paktën tre persona nga stafi 4.3-4.10 qe do te duhet te jene te certifikuar nga MPMS (MFPS) për siguri dhe shëndet ne pune dhe nga AME për mbrojtje ndaj zjarri (pranohet si dëshmi edhe vendimi për certifikim i lëshuar nga MPMS (MFPS) dhe AME).

OE ankues pretendon se ne kemi ofruar listën e stafi me dokumentacionin përcjellës ku ne kuadër te stafit kemi personel te certifikuar nga AME dhe nga MPMS për çfarëdo paqartësie AK ka mundur te kërkoj sqarime, duke pas parasysh edhe volumen e madh te dokumenteve qe janë kërkuar ka mundësi është harruar ndonjë dëshmi pa u ngarkuar për këtë arsye AK është dashur qe te kërkoj sqarime ne mënyrë qe te beje vlerësimin sa ma real.

Eksperti shqyrtues, lidhur me këtë çështje vlerëson se OE ankues nuk i ka ofruar dëshmitë sipas kërkesës se dosjes se tenderit dhe këtë fakt e vërteton edhe vet OE ankues ne ankesën e tij i cili deklaroi se “ka mundësi qe është harruar ndonjë dëshmi pa u ngarkuar”.

Sa i përket arsyes se eliminimit se nuk ka te prezantuar një nga stafi si ekspert i certifikuar për lëmin e saldimit nga një institut kompetent me përvojë se paku pese vite pune pas marrjes se certifikatës.

OE ankues pretendon se ne kemi angazhuar për këtë pozicion z .Arsim Maloku i cili është i certifikuar për salidim, duke pas parasysh edhe volumen e madh te dokumenteve qe janë kërkuar ka mundësi është harruar ndonjë dëshmi pa u ngarkuar për këtë arsye AK është dashur qe te

kërkoj sqarime ne mënyrë qe te beje vlerësimin sa ma real.

Eksperti shqyrtues, vlerëson se nuk qëndron ky pretendim i OE ankues i cili njëjtë sikurse ne pretendimin e lartshënuar deklaroi se “ka mundësi është harruar ndonjë dëshmi pa u ngarkuar”.

Lidhur me arsyetimin e autoritetit kontraktues se OE ankues nuk e plotëson kërkesën nr.5 te te dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontrate, te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2. Ne listën e pajisjeve te ofruara nuk e ka prezantuar pajisjen nr.4 sipas kërkesës , mungon pajisja e renditur ne poz. 4 ne kërkesë (Sisteme për ngritje me vakum për xham, për elemente fasade deri ne 500 kg).

OE ankues, ne ankesën e tij njëjtë sikurse ne rastet e mësipërme, deklaroi e pranoi qe i nuk ka dorëzuar dëshmitë por krejt kjo ka ndodhur për shkak te volumit te ka ndodh gabim teknik ku si shkak i shume dokumenteve qe janë kërkuar ne këtë procedure nuk janë ngarkuar dëshmitë ne lidhje me këtë pajisje.

Eksperti shqyrtues, vlerëson se nuk qëndron pretendimi i OE ankues lidhur me këtë arsyetim të eliminimit sepse i njëjti nuk ka dorëzuar dëshmi për këtë kërkesë të AK-se.

Eksperti shqyrtues, ne fund vlerëson se autoriteti kontraktues i ka respektuar dispozitat e nenit 59 të LPP-së, për faktin se OE ankues, e pranoi se ne ofertën e tij nuk i ka dorëzuar disa dëshmi sipas kërkesave të përcaktuara ne dosje të tenderit dhe të njoftimit për kontrate.

-Lidhur me pretendimet e OE NIKA PrO- Ing SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0074 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i pakënaqur me vendimin (B58) të AK-Ministria e Shëndetësisë, për dhënie të kontratës, ka parashtruar ankese ne OSHP, me pretendimin se AK nuk e ka bere vlerësimin e ofertave duke u bazuar ne dispozitat e LPP-së.

Autoriteti kontraktues pas përfundimit të vlerësimit të ofertave e njoftoi OE ankues me letrën standarde të tenderuesit të eliminuar.

OE ankues eliminohet me arsyetimin si me poshtë se:

Lidhur me arsyen e eliminimit të OE ankues, i cili është eliminuar për gabim ne çmimin për njësi ne pozicionin M 9.11, Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues ne ankesën e tij pretendon se kemi te bëjmë me gabim teknik, pra sipas OE ankues AK/MSH është dashur ti korrigjojë dhe të vazhdoj tutje.

Eksperti shqyrtues vlerëson se nuk qëndron pretendimi i OE ankues, sepse ne rastin konkret kemi të bëjmë me ndryshim të çmimit për njësi i cili sipas dispozitave te nenit 59 të LPP-se, nuk lejohet, pra çmimi për njësi nuk ndryshohet.

Andaj, korrigjimi i çmimit për njësi siç u sqarua edhe me larte, nuk lejohet sipas dispozitave të nenit 59 të LPP-së dhe nuk mund të konsiderohet si gabim teknik..

Sa i përket arsyes së dytë të eliminimit, lidhur me dëshminë bankare të liderit Anion Mep, që sipas AK-se, dëshmia nuk është sipas kërkesës, eksperti shqyrtues, sqaron se në dëshmi nuk ceket se mjetet janë të disponueshme për këtë projekt. Poashtu OE ankues ne ankesën e tij, nuk ofron ndonjë prove të re me të cilën dëshmon por vetëm pretendon se mjetet jane llogari te OE

Anion Mep, pra dëshmia nuk është sipas kërkesës se dosjes se tenderit ku autoriteti kontraktues te kërkesa 2 konkretisht dëshmia ka kërkuar: Dëshmia 2. Letër konfirmimi (Deklaratë) origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni Bankar për OE ose GOE, që vërteton disponueshmërinë e një (1) milion Euro në llogarinë bankare të kompanisë ne disponim për këtë projekt, ose një vërtetim bankar (shënim premtues) që konfirmon se kompania mund të merr kredi te pakushtëzuar prej një (1) milion EUR, nëse është e nevojshme ne emër të projektit.

Lidhur me arsyen e trete, ku sipas AK-se, vendimi për emërimin e stafit janë bere vetëm nga OE Nika si anëtarë i konzorciumit dhe nuk janë të nënshkruara edhe nga lideri i grupit. Lidhur me këtë çështje, eksperti shqyrtues vlerëson se AK, konform nenit 72 te LPP-se është dashur të sqarohet me operatorin ekonomik.

Sa i përket arsytimit të autoritetit kontraktues se lideri i konzorciumit, nuk ka ofruar asnjë inxhinier – staf dhe kjo bie ne kundërshtim me marrëveshjen e konzorciumit, eksperti shqyrtues, vlerëson se nuk qëndron ky arsyetim i autoritetit kontraktues, sepse me marrëveshje të konzorciumit përgjegjësit ndahen me përqindje dhe nuk ndahen stafi apo makineria.

OE ankues, pretendon se arsyetimi i AK-se, lidhur me kërkesën për raport të testimit për X Ray është i pa bazuar, me arsyetimin e anëtari i konzorciumit e ka dorëzuar raportin e pranimit teknik, ne të cilin përmenden të gjitha pajisjet e instaluara përfshirë sistemin X-Ray.

Lidhur me këtë çështje, Eksperti shqyrtues, sqaron se autoriteti kontraktues ka kërkuar raport të testimit të sistemit X – Ray dhe nuk mjafton vetëm raporti i pranimit teknik të pajisjeve të instaluara.

Sa i përket eliminimit të OE ankues, lidhur me atë se E. Suka nuk e ka evidentuar ne CV-in e tij përvojën e punës, eksperti shqyrtues vlerëson se nuk qëndron ky pretendim sepse OE ankues ka dorëzuar edhe referenca në të cilat vërehet përvoja e punës se E. Suka.

Sa i përket arsyes se eliminimit lidhur me mungesën e diplomës se (B. Eminit) si Hidroteknik, OE ankues pretendon se për këtë profesion kemi emëruar edhe (F. Selmanaj) dhe njeherit i kemi bashkangjitur të gjitha dëshmitë sipas kërkesës. Eksperti shqyrtues vlerëson se qëndron ky pretendim sepse ne ofertën e OE ankues gjendet diploma e F. Selmanajt si Hidroteknik.

Lidhur me mungesën se përvojës se (F. Musliut ) instalues i ngrohjes qendrore, eksperti shqyrtues vlerëson se është i diplomuar me datën: 15.06.2020, ndërsa dëshmitë lidhur me përvojën e punës janë nga viti 2021, qe rezulton se e plotëson kërkesën e dosjes se tenderit lidhur me përvojën e punës, po ashtu si dëshmi ka edhe referencë te lëshuar për personin e lartpërmendur.

OE ankues eliminohet nga AK, edhe për disa certifikata me afat të skaduar, për të cilat OE ankues pretendon se kemi dorëzuar mjaftueshme dëshmi, lidhur me këtë kërkesë, eksperti shqyrtues ka vërejtur se disa certifikatat për mbrojtje nga zjarri janë me afat te skaduar mirëpo OE ankues nuk jep asnjë argument lidhur me këtë çështje, prandaj nuk qëndron pretendimi i OE ankues se e kemi plotësuar këtë kërkesë.

Sa i përket mungesës se përvojës se menaxherit të punishtes, për të cilin është dashur të ketë menaxhuar se paku një objekt spitalor, eksperti shqyrtues, vlerëson se nuk është dashur te eliminohet lidhur me këtë arsyetim sepse i menaxheri i emëruar ne CV-in e tij ka një projekt të evidentuar për te cilin është dashur te kërkohen sqarime mbi bazën e nenit 72 te LPP-se.

Lidhur me mungesën e përvojës së punës 10 vjeçare të Inxhinierit të arkitekturës (H. Qorri), eksperti shqyrtues, vlerëson se në CV-in e tij ka prezantuar shumë projekte, mirëpo nuk ka dorëzuar edhe referenca me të cilat do të dëshmonte përvojën e kërkuar.

Lidhur me mungesën e dëshmive – certifikatës së sigurisë dhe shëndetit në punë dhe referencave për inxhinierin (K. Rapi), eksperti shqyrtues, vlerëson se OE ankues nuk i ka dorëzuar dëshmitë minimale për inxhinierin e lartpërmendur, prandaj, nuk qëndron pretendimi i OE ankues.

Sa i përket mungesë së licencës për hartimin e raporteve të VMN për inxhinierin e mjedisit (E. Zaka), OE ankues, pretendon se edhe në këtë rast duhet të kërkohen sqarime sipas nenit 72 të LPP-së. Eksperti shqyrtues, sqaron se nuk janë dorëzuar dëshmitë lidhur me kërkesën/dëshminë për licence për hartimin e raporteve të VMN për inxhinierin e mjedisit.

Sa i përket mungesë së dëshmive / certifikatave të lëshuara nga MPMS për tre persona nga stafi sipas pikës 4.3 dhe 4.10 e dosjes së tenderit, edhe me këtë rast OE ankues pretendon se duhet të kërkohen sqarime shtese sipas nenit 72 të LPP-së. Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues nuk i ka dorëzuar dëshmitë sipas kërkesës së dosjes së tenderit, konkretisht pikës 4.3 dhe 4.10 të dosjes së tenderit.

Sa i përket arsytimit të AK-së, se OE ankues nuk ka ofruar dëshmi për ekspert të certifikuar në lëmin e saldimit nga një institut kompetent, eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues ka ofruar të gjitha dëshmitë tjera përveç certifikimit si ekspert i saldimit, prandaj OE ankues nuk e ka plotësuar kërkesën e AK-së.

Lidhur me arsytimin e AK-së, për mungesën e dëshmive për pajisjet e përcaktuara në letrën standarde, eksperti shqyrtues, vlerëson se në atë rast AK-ja është dashur të kërkojë sqarime lidhur me paqartësitë që i ka pasur sepse OE ankues ka dorëzuar dëshmi sipas kërkesës së DT-së.

OE ankues, pretendon se oferta e OE të rekomanduar për kontratë është e papërgjegjshme me pretendimin se OE i shpallur fitues nuk ka përmbushur kërkesën financiare për vlerën e letrës së përkrahjes/garancisë bankare, pasi është paraqitur një vlerë prej 980,000.00 EUR, ndërkohë që Dosja e Tenderit ka kërkuar shprehimisht vlerën minimale prej 1,000,000.00 EUR. Mungesa prej 20,000.00 EUR përbën mos-përmbushje të një kriteri eliminues financiar dhe, si e tillë, oferta nuk mund të konsiderohet e përgjegjshme në kuptim të Nenit 59 të LPP-së.

Pas ekzaminimit të të gjitha dëshmive lidhur me kërkesën e dosjes së tenderit, eksperti shqyrtues sqaron se dëshmitë e dorëzuara nga OE i rekomanduar janë sipas kërkesës së dosjes së tenderit dhe vlera e ofruar e kalon 1,000,000.00 €.

OE ankues pretendon se konzorciumi i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit lidhur me kontratë dhe referenca.

Kërkesa 2. OE ose GOE duhet të dëshmojë se ka realizuar me sukses projekte të ngjashme-ndërtim ose renovim i objekteve, në vlerë të përgjithshme jo më pak se 15 Milion Euro, gjatë periudhës së shkuar tre vjeçare nga Njoftimi për Kontratë. Në rast të grupit të OE, së paku 51% e punëve të përfunduara kërkohet për liderin e grupit. OE ose GOE duhet të dëshmojë se gjatë përvojës së tij në fushën e ndërtimit ka të përfunduar së paku një projekt spitalor me vlerë të madhe (kërkohet për liderin në rast të grupit), ku të jenë kryer punime lidhur me X-ray, Gaz medicinal, ventilim, klimatizim, dyer X-ray Automatike, etj. (Projektet mund të jenë të filluara edhe me herët por duhet të jenë të përfunduara gjatë periudhës së kaluar 3 vjeçare nga Njoftimi

për Kontratë).

Eksperti shqyrtues, sqaron se AK, gjate vlerësimit të ofertave ka kërkuar sqarime shtese lidhur me kontratat dhe referencat e OE të rekomanduara për kontrate dhe ne përgjigje OE i rekomanduara për kontrate i ka ofruar sqarimet e kërkuara nga autoriteti kontraktues, me të cilat ka arritur të dëshmoj se i njëjti e plotëson kërkesën e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontrate lidhur me referencat e kërkuara sipas kërkesës se cituar me larte, mirëpo për shkak të volumit te madh te shkresave, eksperti shqyrtues nuk mund ti bashkangjes mirëpo të njëjtat gjendet të ngarkuara ne platformën e e-prokurimit.

Sa i përket pretendimit ne lidhje me pajisjen për ngritje xhamave për elemente te fasadës deri ne 500kg, eksperti shqyrtues, vlerëson se nuk qëndron ky pretendim ku OE ankues deklaroi se nga analiza jone rezultoi se pajisja është me kapacitet 600kg, nuk qëndron sepse ne Dud doganor nuk thuhet se është 600 kg.

Sa i përket pretendimit të OE ankues, lidhur me kërkesën nr.4 të dosjes se tenderit, ku OE ankues pretendon se i rekomanduari për kontratë nuk i ka ofruar dëshmitë sipas kërkesës se AK për 40 persona si staf teknik, eksperti shqyrtues sqaron se nuk qëndron sepse dëshmitë janë sipas kërkesës se dosjes se tenderit dhe njeherit sqaroj se i rekomanduari për kontratë ne ofertën e tije ka ofruar 48 persona lidhur me këtë kërkesë te dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontrate.

Poashtu OE ankues pretendon se Konsorciumi i shpallur fitues, në listën e stafit të paraqitur, ka deklaruar z. Nikolla Dani i cili është paraqitur te të dy operatore ekonomik qe kanë aplikuar ne këtë aktivitet të prokurimit dhe sipas OE ankues është dashur të verifikojë këtë fakt. Eksperti shqyrtues vlerëson se prezantimi i dëshmimeve ne dy oferta nuk përben ndonjë shkelje ligjore sipas dispozitave të LPP-se, prandaj nuk qëndron ky pretendim.

OE ankues pretendon se me Vendimin e PSH-se nr. 1278/25 OSHP, e ka vendosur ne liste te zeze nje operatorë ekonomik, për të cilin inxhinieri V. Goxhuli, ka deklaruar se nuk jam pjese e stafit ne asnje kompani tjeter, andaj OE ankues pretendon se inxhinieri ne fjale nuk eshte pjese e OE te rekomanduara për kontratë. Eksperti shqyrtues, vlerëson se nuk qëndron ky pretendim.

Eksperti shqyrtues, në fund vlerëson se AK e ka respektuar në tërësi nenin 59 të LPP-së, sepse në oferta e OE ankues, ka një gabim i cili nuk mund të korrigjohet sipas dispozitave të nenit 59 të LPP-se, për shkak të gabimit ne çmim për njësi, i cili sipas dispozitave të nenit 59 të LPP-se, mbizotëron dhe nuk mund të ndryshohet.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorve ekonomik ankues. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Raporti i ekspertit shqyrtues ka vlersuar se pretendimet e operatorve ekonomik ankues janë të pa bazuara dhe mbeten ne fuqi vendimi i autoritetit kontraktues.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, parashtrësat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse në këtë rast.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktiviteti të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertës shqyrtuese dhe mendimi i saj janë të pranueshme sa i perket rekomandimit që të mbetet ne fuqi vendimi i autoritet kontraktues dhe se Paneli me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes pa nevojë që të njëjtat të përsëriten.

Në nga raporti i ekspertës shqyrtuese, dëshmitë e prezantuara nga operatorët ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin rekomandimit në raportin e ekspertit shqyrtues që të mbetet ne fuqi vendimi i autoritetit kontraktues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se pretendimet e operatorëve ekonomik ankues janë pjesërisht të bazuara. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesat e Operatorit Ekonomik OE"Acerler Insaat Taahot MadenCilik Muhedislik Nakliyat Ve Sarrafiye Tiic.LTD.Sti", OE"Nika Pro- Ing" SH.P.K si dhe OE"Ada Consulting Group" SH.P.K, duhet të Aprovohen si pjesërisht të bazuara, por të pa mjaftueshme për të ndryshuar vendimin e

autoritetit kontraktues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi Njoftimi mbi vendimin për dhënie të kontratës e Autoritetit Kontraktues – Ministria e Shëndetësisë., lidhur me aktivitetin e prokurimit “RITENDER “Ndërtimi i Qendrës së Mjekësisë Emergjente në QKUK – vazhdim projekti”, me numër të prokurimit 206-25-8662-5-1-1.

Paneli vren se lidhur me ankesën me numer 2026/0069 nder te tjera sa i perket arsyes se eliminimit të OE ankues se nuk ka ofruar dëshmi – raport të testimit X ray, por ka dorëzuar raport të kalibrimit të pajisjes, eksperti shqyrtues, sqaron se AK/MSH, në dosje të tenderit të kërkesa-dëshmia nr. 2 ekspertit shqyrtues ka vlerësuar se AK, ka mund të sqarohet duke u bazuar në nenin 72 të LPP-së, por se ankuesi në arsyetimin e eliminimit, në ofertën e tij ka vendosur qmime për njësi të gabuara, 1,285.20 ndërsa është dashur të vendoset 918.00€, njësoj ka vepruar edhe në dy pozicione tjera dhe sipas dispozitave të Nenit 59 të LPP-se, nuk lejohen, andaj ska baze të majftueshme për të ndryshuar vendimin e AK. Po ashtu lidhur me ankesën 2026/0073 nder tjera sa i perket dëshmisë për hidroizoluesin, ka pasur hapesire ligjore të zbatohet dispozita e nenit 72 të LPP, mirepo e pamjaftueshme që kjo ankese të aprovohet si e bazuar pasi që edhe vete OE ankues e ka pranuar në pretendimet tjera se si shkak i volumit është bere një lëshim teknik dhe është harruar një certifikat e caktuar dhe e njëjta nuk është dorëzuar. Ndersa lidhur me ankesën 2026/0074 sa i përket mungesës së përvojës së menaxherit të punishtes, për të cilin është dashur të ketë menaxhuar se paku një objekt spitalor menaxheri në CV-in e tij ka një projekt të evidentuar për të cilin është dashur të kërkohej sqarime mbi bazën e nenit 72 të LPP-se, mirëpo OE në arsyetim të eliminimit oferta e tij ka pasur gabime në çmim për njësi, i cili sipas dispozitave të nenit 59 të LPP-se, nuk mund të ndryshohet, andaj ankuesit nuk kanë arritur të dëshmojnë mjaftueshëm me prova konkrete se ka pasur shkelje ligjore nga ana e autoritetit kontraktues gjatë zhvillimit të aktivitetit të prokurimi.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportet e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet vlersimet e ekspertit shqyrtues me rekomandim, të cilët kanë shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij me numër; 2026/069,073 dhe 074, se gjatë zhvillimit të kësaj procedurë të prokurimit, autoriteti kontraktues ka zbatuar dispozitat ligjore të LPP-së.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj" lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themelojë një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"

Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendosë po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Paneli shqyrtues bazuar në faktin aprovimin të pjeserishëm të ankesës të operatoreve ekonomik ankues; OE "Acerler Insaat Taahot MadenCilik Muhedislik Nakliyat Ve Sarrafiye Tiic.LTD.Sti", OE "Nika PrO- Ing" SH.P.K si dhe OE "Ada Consulting Group" SH.P.K., i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatorët ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Isa Hasani**

*Hasani*

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTERIA E SHËNDETËSISË, MINISTERIA E SHËNDETËSISË, MINISTERIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - Acerler Insaat Taahot Madencilik Muhendislik Nakliyat Ve Sarrafiye Tiic.LTD.Sti, ADA CONSULTING GROUP SH.P.K., NIKA PrO- Ing SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: